



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

**Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit**

**Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe**

**STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I TRETË  
DISERTACION DOKTORATURE**

**TEZA: Analizë etnolinguistike në disa vepra të Fatos  
Kongolit**

Kandidati:

Mr. Donika Bakiu

Mentor:

Prof. dr. Zeqir Kadriu

**Tetovë,  
2023**

**DEKLARATA E STUDENTIT:**

Unë Donika Bakiu, me përgjegjësi morale dhe ligjore, deklaroj se ky disertacion i doktoraturës është studimi im kërkimor, i cili është realizuar si pjesë e kërkesës për diplomim në ciklin e tretë në Universitetin e Evropës Juglindore në Maqedoninë e Veriut. Materialet e marra nuk çënojnë të drejtën e autorit sepse çdo material është cituar në bazë të rregullave akademike, duke përdorur citate, referenca dhe literaturë.

## MIRËNJOHJE

Mirënjohje për të gjithë ata që më dhanë mbështetje morale, inkurajim dhe motivim për të arritur qëllimet e jetës akademike. Mirënjohje të gjithë atyre që më krijuan mundësinë, më dhanë ndihmë të nxjerr në pah, të nxjerr në dritë këtë studim, ndjehem falemenderuese përjetësisht. Për realizimin e kësaj teme doktrale dua të falënderoj mentorin tim, prof. dr. Zeqir Kadriun, këshillat, mbështetjen e vazhdueshme dhe durimin gjatë studimeve të doktoraturës. Mirënjohje për të gjithë profesorët sepse me njohuritë e tyre të pafundme, motivimi dhe durimi më kanë dhënë më shumë fuqi dhe shpirt për të shkëlqyer në punimet shkencore. Dëshiroj të shpreh mirënjohjen time për prindërit dhe motrën time. Pa mirëkuptimin dhe inkurajimin e tyre të jashtëzakonshëm, do të ishte e pamundur për mua të përfundoja studimin tim.

Dy linjat e mia të shpëtimit (prindërit) më kanë mbështetur gjithmonë financiarisht dhe moralisht në mënyrë që t'i kushtoj vëmendje vetëm studimeve dhe arritjes së objektivit tim pa asnjë pengesë në rrugë.

Përgjithmonë e juaja Donika!

## **PËRMBLEDHJE**

Fatos Kongoli është një nga autorët më produktivë të njëzetë viteve të fundit në letërsinë shqipe. Ai është autor i katërmëdhjetë romaneve, të cilat kanë zënë vend në diskutimet tona letrare. Përpos që është produktiv, Kongoli është edhe njëri nga autorët më të vlerësuar nga kritika letrare shqiptare, si dhe ndër shkrimtarët më të lexuar nga lexuesi shqiptar. Edhe pse në fillimet e tij ai u mor me tregime, njohja e tij nga lexuesi dhe kritika shqiptare u bë përmes romanit. Edhe sot e kësaj dite, romanet e tij vazhdojnë të jenë më të kërkuarat nga lexuesit shqiptarë. Veçanërisht romani i tij “I humburi” u shndërrua në një roman-kult për periudhën e tranzicionit shqiptar, për periudhën kalimtare në mes të komunizmit dhe demokracisë në Shqipëri. Veprat e tij, sidomos “Bolero në Vilën e Pleqve, “I humburi”, “Lëkura e qenit”, “Jeta në një kuti shkrepësesh”, “Te Porta e Shën Pjetrit” dhe “Kufoma”.

“I humburi”, është një lloj pasaporte e letërsisë narrative të Fatos Kongolit. Përmes këtij romani, ai u bë i njohur e i dashur, si për lexuesin shqiptar, poashtu edhe për atë të huaj. Kjo, ia hapi dyert vendore e ndërkombëtare, duke u përkthyer në shumë gjuhë të njohura të botës. Për të kanë folur e shkruar shkrimtarë e kritikë evropianë, veçmas ata francezë, duke e vlerësuar lart romanin e këtij autori shqiptar.

Romanet e Fatos Kongolit, krijojnë përshtypje dhe arrijnë të sfidojnë me elementet e tyre tematikë e ideor lexuesin, duke ngërthyer në vete treshen kryesore të veprave narrative të tij, si “Te porta e Shën Pjetrit”, “I humburi” dhe “Lëkura e qenit”, që për mendimin tonë, përbëjnë atë treshen kryesore të veprave narrative të Fatos Kongolit. Poashtu ne kemi dhe tri vepra të tjera për studim: “Kufoma”, “Jeta në një kuti shkrepësesh” dhe “Bolero në vilën e pleqve”. Në gjashtë romanet është bërë shqyrtim etnokulturor pra përdorimin e nofkave, përdorimin e eufemizmave, përdorimin e mallkimeve popullore, përdorimin e ngushëllimeve, ofendimet, sharrjet, betimet. Në veprat e Fatos Kongolit që patëm për studim gjetëm një numër të madh ofendimesh (sharjesh). Më pas është pjesa e shqyrtimeve onomastike pra emrat dhe mbiemrat, emrat e kafshëve, emrat e banimeve, më pas është pjesa e shqyrtimeve leksikologjike pra fjalët e urta, njësitë frazeologjike, dialektizmat, historizmat arkaizmat etj. Poashtu është pjesa e shqyrtimeve folklorike të gjashtë veprave të Fatos Kongolit. Në punim është përfshirë analiza sematike krahasuese të gjashtë veprave të Fatos Kongolit “Bolero në Vilën e Pleqve, “I humburi”, “Lëkura e qenit”, “Jeta në një kuti shkrepësesh”, “Te Porta e Shën Pjetrit” dhe “Kufoma”.

**Fjalët kyçe:** studim, roman, etnolingustikë, onomastikë etj.

## АПСТРАКТ

Фатос Конголи е еден од најпродуктивните автори во последните дваесет години во албанската литература. Тој е автор на четиринаесет романи, кои се одвивале во нашите литературни дискусии. Освен што е продуктивен, Конголи е и еден од најценетите автори од албанските литературни критичари, како и еден од најчитаните писатели од албанскиот читател. Иако во неговите почетоци се занимаваше со приказни, неговото препознавање од албанскиот читател и критичар беше направено преку романот.

И денес неговите романи продолжуваат да бидат најбарани од албанските читатели. Особено неговиот роман “I humburi” стана култен роман за периодот на албанската транзиција, за преодниот период помеѓу комунизмот и демократијата во Албанија. Неговите романи, особено “Bolero në Vilën e Pleqve”, “I humburi”, “Lëkura e qenit”, “Jeta në një kuti shkrepsësh”, “Te Porta e Shën Pjetrit” и “Kufoma”. “I humburi”, тоа е еден вид пасош на наративната литература на Фатос Конголи. Преку овој роман стана познат и сакан, како кај албанските, така и кај странските читатели. Ова ги отвори своите домашни и меѓународни врати, преведено на многу популарни јазици во светот. За тоа зборувале и пишуваале европските писатели и критичари, особено француските, високо ценејќи го романот на овој албански автор. Романите на Фатос Конголи создаваат впечаток и успеваат да го предизвикаат читателот со нивните тематски и идеолошки елементи, опфаќајќи го главното трио од неговите наративни дела, како “Te porta e Shën Pjetrit”, “I humburi” и “Lëkura e qenit”, дека според нас, го сочинуваат главното трио на наративните дела на Фатос Конголи. Исто така имаме и три други романи за проучување: “Kufoma”, “Jeta në një kuti shkrepsësh” и “Bolero në vilën e pleqve”. Во шесте романи е направено етнокултурно испитување, односно употреба на прекари, употреба на еуфемизми, употреба на народни пцости, употреба на утеха, навреди, клетви, заклетви. Во романите на Фатос Конголи кои ги имавме за проучување најдовме голем број навреди (пцуење). Потоа, делот на ономастички прегледи, односно имиња и презимиња, имиња на животни, имиња на живеалишта, потоа делот на лексиколошки прегледи, т.е. поговорки, фразеолошки единици, дијалектизми, историцизми, архаизми итн. Тоа е и дел од фолклорни критики на шест дела на Фатос Конголи. Во трудот е вклучено компаративна семантичка анализа на шест романи на Фатос Конголи “Bolero në Vilën e Pleqve”, “I humburi”, “Lëkura e qenit”, “Jeta në një kuti shkrepsësh”, “Te Porta e Shën Pjetrit” и “Kufoma”.

**Клучни зборови::** студија, роман, етнолингвистика, ономастика итн.

## ABSTRACT

Fatos Kongoli is one of the most productive authors of the last twenty years in Albanian literature. He is the author of fourteen novels, which have taken place in our literary discussions. Besides being productive, Kongoli is also one of the authors most appreciated by Albanian literary critics, as well as among the most read writers by Albanian readers. Although in his beginnings he dealt with stories, his recognition by Albanian readers and critics was through the novel. Even today, his novels continue to be the most sought after by Albanian readers. Especially his novel "I humburi" was transformed in a cult novel for the Albanian transition period, for the transitional period between communism and democracy in Albania. His novels, especially "Bolero në Vilën e Pleqve", "I humburi", "Lëkura e qenit", "Jeta në një kuti shkrepsësh", "Te Porta e Shën Pjetrit" and "Kufoma". "I humburi", it is a kind of passport of Fatos Kongoli's narrative literature. Through this novel, he became known and loved, both for Albanian and foreign readers. This opened local and international doors, being translated into many well-known languages of the world. European writers and critics have spoken and written about it, especially the French ones, highly appreciating the novel of this Albanian author.

Fatos Kongoli's novels create an impression and manage to challenge the reader with their thematic and ideological elements, encompassing the main trio of his narrative works, such as "Te porta e Shën Pjetrit", "I humburi" and "Lëkura e qenit", which, in our opinion, constitute the main trio of Fatos Kongoli's narrative works. We also have three other works for study: "Kufoma", "Jeta në një kuti shkrepsësh" and "Bolero në vilën e pleqve". In the six novels, an ethnocultural examination was made, i.e. the use of nicknames, the use of euphemisms, the use of popular curses, the use of consolations, insults, curses, oaths.

In the works of Fatos Kongoli that we had for study, we found a large number of insults (swearing). Then there is the part of onomastic examinations, i.e. names and surnames, animal names, names of residences, then there is the part of lexicological examinations, i.e. proverbs, phraseological units, dialectics, historicisms, archaisms, etc. It is also the section of folklore reviews of six works by Fatos Kongoli. The paper includes a comparative schematic analysis of six works by Fatos Kongoli "Bolero në Vilën e Pleqve", "I humburi", "Lëkura e qenit", "Jeta në një kuti shkrepsësh", "Te Porta e Shën Pjetrit" and "Kufoma".

**Key words:** study, novel, ethnolinguistics, onomastics, etc.

## **Përmbajtje:**

|                                                |    |
|------------------------------------------------|----|
| MIRËNJOHJE.....                                | 3  |
| PËRMBLEDHJE .....                              | 4  |
| АПСТРАКТ .....                                 | 5  |
| Hyrje.....                                     | 13 |
| Lënda e hulumtimit.....                        | 15 |
| Qëllimet e hulumtimit.....                     | 15 |
| Hipotezat.....                                 | 15 |
| Metodologjia e hulumtimit.....                 | 16 |
| Metodologjia e kërkimit.....                   | 17 |
| Rëndësia e punimit .....                       | 17 |
| Jeta dhe vepra e Fatos Kongolit .....          | 18 |
| KREU I PARË SHQYRTIME TEORIKE .....            | 19 |
| Etnokultura .....                              | 19 |
| a. Nofkat.....                                 | 19 |
| b. Eufemizmat .....                            | 20 |
| c. Urimet dhe fjalët përkëdhelëse .....        | 21 |
| d.Mallkimet popullore .....                    | 21 |
| e. Ngushëllimet .....                          | 22 |
| f.Ofendimet (sharjet) .....                    | 22 |
| 2. Onomastika .....                            | 23 |
| a.Emrat e banimit dhe tempujve .....           | 23 |
| b.Emrat dhe mbiemrat si shenjë identiteti..... | 24 |
| 3. Leksikologjia.....                          | 25 |
| a. Fjalët e urta .....                         | 26 |
| b. Njësitë frazeologjike .....                 | 26 |
| c.Dialektizmat.....                            | 27 |
| d. Arkaizmat .....                             | 29 |
| e.Historizmat.....                             | 29 |
| f.Huazimet.....                                | 30 |
| KAPITULLI I DYTË .....                         | 31 |
| ANALIZA ETNOLINGUISTIKE E VEPRAVE.....         | 31 |
| VEPRA I.....                                   | 31 |
| ROMANI “BOLERO NË VILËN E PLEQVE ” .....       | 31 |

|                                                       |    |
|-------------------------------------------------------|----|
| 1. SHQYRTIME ETNOKULTURORE .....                      | 32 |
| a) Përdorimi i nofkave.....                           | 32 |
| b) Përdorimi i eufemizmave.....                       | 32 |
| c) Përdorimi i urimeve dhe fjalëve përkëdhelëse ..... | 32 |
| ç) Përdorimi i mallkimeve popullore.....              | 33 |
| d) Përdorimi i ngushëllimeve .....                    | 33 |
| e) Ofendimet (sharrjet) .....                         | 33 |
| Shqyrtime onomastike .....                            | 34 |
| a) Emrat e banimit dhe tempujve .....                 | 34 |
| b) Emrat dhe mbiemrat si shenjë indentiteti.....      | 34 |
| c) Emra kafshësh .....                                | 34 |
| Shqyrtime leksikologjike .....                        | 35 |
| a)Pasqyrimi i fjalëve të urta .....                   | 35 |
| b) Pasqyrimi i njësive frazeologjike.....             | 35 |
| c) Pasqyrimi i dialektizmave.....                     | 36 |
| d)Pasqyrimi i arkaizmave .....                        | 36 |
| e)Pasqyrimi i historizmave .....                      | 36 |
| f)Pasqyrim i huazimeve.....                           | 36 |
| VEPRA II.....                                         | 37 |
| ROMANI " I HUMBURI " .....                            | 37 |
| 1. SHQYRTIME ETNOKULTURORE .....                      | 38 |
| a) Përdorimi i nofkave.....                           | 38 |
| b) Përdorimi i eufemizmave.....                       | 38 |
| c) Përdorimi i urimeve dhe fjalëve përkëdhelëse ..... | 38 |
| ç) Përdorimi i mallkimeve popullore.....              | 39 |
| d) Përdorimi i ngushëllimeve .....                    | 39 |
| e) Ofendimet (sharrjet) .....                         | 39 |
| Shqyrtime onomastike .....                            | 40 |
| a) Emrat e banimit dhe tempujve .....                 | 40 |
| b)Emrat dhe mbiemrat si shenjë indentiteti.....       | 40 |
| c)Emra kafshësh .....                                 | 40 |
| Shqyrtime leksikologjike .....                        | 41 |
| a) Pasqyrimi i fjalëve të urta .....                  | 41 |
| b) Pasqyrimi i njësive frazeologjike .....            | 41 |



|                                                       |    |
|-------------------------------------------------------|----|
| c) Pasqyrimi i dialektizmave.....                     | 42 |
| d) Pasqyrimi i arkaizmave .....                       | 43 |
| e) Pasqyrimi i historizmave .....                     | 43 |
| f) Pasqyrim i huazimeve .....                         | 43 |
| VEPRA III .....                                       | 43 |
| ROMANI “LËKURA E QENIT” .....                         | 43 |
| 1. SHQYRTIME ETNOKULTURORE .....                      | 44 |
| a) Përdorimi i nofkave .....                          | 44 |
| b) Përdorimi i eufemizmave.....                       | 45 |
| c) Përdorimi i urimeve dhe fjalëve përkëdhelëse ..... | 45 |
| ç) Përdorimi i mallkimeve popullore.....              | 45 |
| d) Përdorimi i ngushëllimeve .....                    | 45 |
| e) Ofendimet (sharrjet) .....                         | 46 |
| Shqyrtime onomastike .....                            | 46 |
| a) Emrat e banimit dhe tempujve .....                 | 46 |
| b) Emrat dhe mbiemrat si shenjë indentiteti.....      | 47 |
| c) Emra kafshësh.....                                 | 47 |
| Shqyrtime leksikologjike .....                        | 47 |
| a) Pasqyrimi i fjalëve të urta .....                  | 47 |
| b) Pasqyrimi i njërive frazeologjike.....             | 48 |
| ç) Pasqyrimi i dialektizmave.....                     | 49 |
| d) Pasqyrimi i arkaizmave .....                       | 49 |
| e) Pasqyrimi i historizmave .....                     | 50 |
| f) Pasqyrim i huazimeve .....                         | 50 |
| VEPRA IV.....                                         | 50 |
| ROMANI “JETË NË NJË KUTI SHKREPËSESH ” .....          | 50 |
| 1. SHQYRTIME ETNOKULTURORE .....                      | 51 |
| a) Përdorimi i nofkave .....                          | 51 |
| b) Përdorimi i eufemizmave.....                       | 51 |
| c) Përdorimi i urimeve dhe fjalëve përkëdhelëse ..... | 52 |
| ç) Përdorimi i mallkimeve popullore.....              | 52 |
| d) Përdorimi i ngushëllimeve .....                    | 52 |
| e) Ofendimet (sharrjet) .....                         | 52 |
| Shqyrtime onomastike .....                            | 53 |

|                                                       |    |
|-------------------------------------------------------|----|
| a)Emrat e banimit dhe tempujve .....                  | 53 |
| b)Emrat dhe mbiemrat si shenjë indentiteti.....       | 54 |
| c)Emra kafshësh .....                                 | 54 |
| Shqyrtime leksikologjike .....                        | 54 |
| a)Pasqyrimi i fjalëve të urta .....                   | 54 |
| b)Pasqyrimi i njësive frazeologjike.....              | 55 |
| ç) Pasqyrimi i dialektizmave.....                     | 56 |
| d)Pasqyrimi i arkaizmave .....                        | 56 |
| e)Pasqyrimi i historizmave .....                      | 56 |
| f)Pasqyrim i huazimeve.....                           | 56 |
| VEPRA V.....                                          | 57 |
| ROMANI “TE PORTA E SHËN PJETRIT ” .....               | 57 |
| 1. SHQYRTIME ETNOKULTURORE .....                      | 57 |
| a) Përdorimi i nofkave.....                           | 57 |
| b) Përdorimi i eufemizmave.....                       | 58 |
| c) Përdorimi i urimeve dhe fjalëve përkëdhelëse ..... | 58 |
| ç) Përdorimi i mallkimeve popullore.....              | 59 |
| d) Përdorimi i ngushëllimeve .....                    | 59 |
| e) Ofendimet (sharrjet) .....                         | 59 |
| Shqyrtime onomastike .....                            | 59 |
| a)Emrat e banimit dhe tempujve .....                  | 60 |
| b)Emrat dhe mbiemrat si shenjë indentiteti.....       | 60 |
| c)Emra kafshësh .....                                 | 60 |
| Shqyrtime leksikologjike .....                        | 61 |
| a)Pasqyrimi i fjalëve të urta .....                   | 61 |
| a)Pasqyrimi i njësive frazeologjike.....              | 61 |
| ç) Pasqyrimi i dialektizmave.....                     | 63 |
| d)Pasqyrimi i arkaizmave .....                        | 63 |
| e)Pasqyrimi i historizmave .....                      | 63 |
| d)Pasqyrim i huazimeve .....                          | 63 |
| VEPRA VI.....                                         | 64 |
| ROMANI “KUFOMA ” .....                                | 64 |
| 1. SHQYRTIME ETNOKULTURORE .....                      | 65 |
| a) Përdorimi i nofkave.....                           | 65 |

|                                                                      |    |
|----------------------------------------------------------------------|----|
| b) Përdorimi i eufemizmave.....                                      | 65 |
| c) Përdorimi i urimeve dhe fjalëve përkëdhelëse .....                | 65 |
| ç) Përdorimi i mallkimeve popullore.....                             | 66 |
| d) Përdorimi i ngushëllimeve .....                                   | 66 |
| e) Ofendimet (sharrjet) .....                                        | 66 |
| Shqyrtime onomastike .....                                           | 67 |
| a) Emrat e banimit dhe tempujve .....                                | 67 |
| b)Emrat dhe mbiemrat si shenjë indentiteti.....                      | 67 |
| c)Emra kafshësh .....                                                | 68 |
| Shqyrtime leksikologjike .....                                       | 68 |
| a) Pasqyrimi i fjalëve të urta .....                                 | 68 |
| b)Pasqyrimi i njësive frazeologjike.....                             | 68 |
| c) Pasqyrimi i dialektizmave.....                                    | 69 |
| ç)Pasqyrimi i arkaizmave.....                                        | 70 |
| d)Pasqyrimi i historizmave .....                                     | 70 |
| e)Pasqyrim i huazimeve .....                                         | 70 |
| KAPITULLI I TRETË .....                                              | 70 |
| III – ANALIZË SEMANTIKE KRAHASUESE E VEPRAVE TË FATOS KONGOLIT ..... | 70 |
| ETNOKULTURË .....                                                    | 70 |
| PËRDORIMI I NOFKAVE NË GJASHTË VEPRAT .....                          | 70 |
| <b>Përfundime</b> .....                                              | 73 |
| PËRDORIMI I EUFEMIZMAVE NË GJASHTË VEPRAT .....                      | 73 |
| <b>Përfundime</b> .....                                              | 77 |
| PËRDORIMI I URIMEVE DHE FJALËVE PËRKËDHELËSE NË GJASHTË VEPRAT ..... | 77 |
| <b>Përfundime</b> .....                                              | 79 |
| PËRDORIMI I MALLKIMEVE POPULLORE NË GJASHTË VEPRAT .....             | 79 |
| <b>Përfundime</b> .....                                              | 81 |
| PËRDORIMI I NGUSHËLLIMEVE NË GJASHTË VEPRAT .....                    | 81 |
| Përfundime .....                                                     | 83 |
| PËRDORIMI I OFENDIMEVE(SHARRJEVE) NË GJASHTË VEPRAT .....            | 83 |
| Përfundime .....                                                     | 87 |
| ONOMASTIKË .....                                                     | 87 |
| PËRDORIMI I EMRAVE TË BANIMIT DHE TEMPUIJVE NË GJASHTË VEPRAT.....   | 87 |
| Përfundime .....                                                     | 91 |

|                                                                               |     |
|-------------------------------------------------------------------------------|-----|
| PËRDORIMI I EMRAVE DHE MBIEMRAVE SI SHENJË IDENTITETI NË GJASHTË VEPRAT ..... | 91  |
| Përfundime .....                                                              | 94  |
| PËRDORIMI I EMRAVE TË KAFSHËVE NË GJASHTË VEPRAT .....                        | 95  |
| Përfundime .....                                                              | 96  |
| LEKSIKOLOGJI .....                                                            | 97  |
| PËRDORIMI I FJALËVE TË URTA NË GJASHTË VEPRAT .....                           | 97  |
| Përfundime .....                                                              | 100 |
| PËRDORIMI I NJËSIVE FRAZELOGJIKE NË GJASHTË VEPRAT .....                      | 100 |
| <b>Përfundime</b> .....                                                       | 114 |
| PËRDORIMI I DIALEKTIZMAVE NË GJASHTË VEPRAT .....                             | 116 |
| Përfundime .....                                                              | 117 |
| PËRDORIMI I ARKAIZMAVE NË GJASHTË VEPRAT .....                                | 117 |
| Përfundime .....                                                              | 118 |
| PËRDORIMI I HISTORIZMAVE NË GJASHTË VEPRAT .....                              | 118 |
| Përfundime .....                                                              | 120 |
| PËRDORIMI I HUAZIMEVE NË GJASHTË VEPRAT .....                                 | 120 |
| Përfundime .....                                                              | 125 |
| PËRDORIMI I INSTRUMENTEVE MUZIKORE NË GJASHTË VEPRAT .....                    | 129 |
| <b>Përfundime</b> .....                                                       | 130 |
| ANALIZË STATISTIKORE .....                                                    | 131 |
| <b>FJALORTH I TERMAVE</b> .....                                               | 132 |
| SHKURTESA .....                                                               | 197 |
| Përfundime .....                                                              | 198 |
| Bibliografia .....                                                            | 204 |
| Fjalorë: .....                                                                | 204 |
| Veprat e Fatos Kongolit: .....                                                | 204 |
| Literaturë shkencore: .....                                                   | 204 |

## Hyrje

Duke u nisur gjithmonë nga fjalët e profesor Françesko Altimarit *"Studentet janë shpresa e shkencës"*, më lind dëshira të punoj sa më shumë e të studioj sa më shumë për t'i shpreh aftësitë komunikuese e shkencore. *"Puna e shkencëtarit është si stafeta tek stadiumi kur kanë vrapim,,,* thotë profesor Altimari dhe shton, *"Çdo brez duhet të këtë stafetë e t'ia dorëzoj të tjerëve,gjithmonë sa më përpara,por shkenca duhet të jetë si mbarim brenda stadiumit ku secila gjeneratë duhet ta sjellë më përpara se ku e mori stafetën e dijes"*. Pra tani është koha të punojmë ne,ata para nesh punuan aq sa patën mundësi tani stafetën po na dorëzojnë neve, kurse në këtë stafetë duhet t'ua dorëzojmë gjeneratave të reja gjithmonë sa më para.Gjatë studimeve të ciklit të parë (bachelor) dhe në ato pasuniversitare pra të ciklit të dytë (master) romani bashkëkohor shqiptar, gjithnjë na ka tërhequr dhe interesimi ynë për të shkruar rreth tij ka qenë i vazhdueshëm. Gjatë studimeve jemi njohur me shumë vepra e autorë tanë bashkëkohor, gjë që ka nxitur kureshtjen tonë për studime të mëtutjeshme. Gjatë studimeve të ciklit të parë jemi takuar edhe me romanet e Fatos Kongolit, që është njëri nga autorët më produktivë dhe më domethënës të bashkëkohësisë letrare shqiptare. E mbaj mend si sot ligjëratën nga prof.dr. Hamit Xhaferi për Fatos Kongolin, në lëndën e letërsisë bashkëkohore shqipe. Prej atëherë vendosa se do ta studioj më thellësisht këtë autor. Por zgjodhëm t'i studiojmë nga ana etnolinguistike disa vepra të Fatos Kongolit. Të hysh në një vepër letrare do të thotë të ndryshosh univers dhe të hapesh ndaj horizonteve të reja sepse vërtetë ndjehesh ndryshe. Një vepër e vërtetë qaset, në të njëjtën kohë, si zbulim i një pragu të pakapërcyeshëm, por dhe si një urë mbi këtë prag të pakapërcyeshëm. Bashkëkohore apo tradicionale qoftë, vepra letrare imponon një rend,i cili tenton të thyjë rendin ekzistues, duke afirmuar rregullat e veta të reja.( Kayser. W, Die Wahrheit der Dichter, Hamburg, 1939,fq. 23) Romani është një gjini ndërkulturore, ndërnacionale, ndërligjërimoredhe ndërsemiotike. Është ndërkulturore,sepse kapërcen kultura të ndryshme pa qenë e nevojshme që ato të kenë domosdoshmërisht pika të përbashkëta. Në zhvillimin e tij, ai kapërcen kufijtë kombëtarë dhe ato të gjuhëve. Romani shkruhet duke u nisur nga format e ligjëritimit që ndajnë elementë të përbashkët: raporti midis rrëfimit dhe narratorit, shenjat e kohës dhe të hapësirës ose të personazheve. Roman është pjesë e rrëfimit të gjatë në prozën letrare. Proza narrative ka për qëllim të argëtojë dhe të tregojë një histori. Është një përshkrim i një

zinxhiri ngjarjesh që përfshin një kastë personazhesh, një mjedis dhe një fund. Studimet gjuhësore në gjuhën shqipe në ditët e sotme janë të shumta, duke trajtuar, çështje, fenomene apo dukuri, që u përkasin rrafshëve të ndryshme, në studime, referate apo monografi. Studimet gjuhësore në gjuhën shqipe në ditët e sotme janë të shumta, duke trajtuar, çështje, fenomene apo dukuri, që u përkasin rrafshëve të ndryshme, në studime, referate apo monografi. Studiues të shquar të gjuhës shqipe, si Aleksandër Xhuvani, Eqrem Çabej, Shaban Demiraj, Mahir Domi, Idriz Ajeti kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm, duke bërë studime me rezultate konkrete në disiplina të ndryshme dhe duke krijuar kështu shkencën tonë gjuhësore. Në një vështrim të përgjithshëm mund të themi se për personalitetin e Fatos Kongolit janë bërë studime të shumta, por ne e pamë të arsyeshme që në këtë kurorëzim të studimeve të doktoratës të marrim Fatos Kongolin si autor në një aspekt krejt të veçantë, me titull : “Analizë etnolinguistike në disa vepra të Fatos Kongolit”. Struktura e temës është ndërtuar në përputhje me qëllimet tona. Në këtë punim bosht kryesor janë gjashtë vepra të Fatos Kongolit, të cilat më kanë dhënë vërtetë një kënaqësi teksa i lexoja. Gjithnjë ndjeja se në çdo faqe të librit zbuloja diçka të re dhe i rikthehesha rishtazi. Struktura e kësaj teze të doktoratës përbëhet nga hyrja, analizë për gjashtë veprat: “Bolero në Vilën e Pleqve, “I humburi”, ”Lëkura e qenit”, “Jeta në një kuti shkrepësesh”, ”Te Porta e Shën Pjetrit” dhe “Kufoma” të Fatos Kongolit. Kreu i Parë i punimit është për shqyrtimet teorike; për etnokulturën, nofkat, eufemizmat, urimet dhe fjalët përkëdhelëse, mallkimet popullore, ngushëllimet, ofendimet dhe sharjet. Më pas është pjesa e onomastikës: Emrat e banimit dhe tempujve, Emrat dhe mbiemrat si shenjë identiteti, Emra kafshësh. Më pas është pjesa e leksikologjisë: fjalët e urta , njësitë frazeologjike, dialektizmat, arkaizmat, historizmat. Në kreun e dytë është analiza etnolinguistike e veprave. Duke filluar me veprën “Bolero në Vilën e Pleqve, “I humburi”, ”Lëkura e qenit”, “Jeta në një kuti shkrepësesh”, ”Te Porta e Shën Pjetrit” dhe “Kufoma”. Pra këto gjashtë vepra janë pjesë e tezës së doktoratës. Në kreun e tretë është: analiza semantike krahasuese të veprave të Fatos Kongolit. Më pas është pjesa e shqyrtimeve onomastike, shqyrtimeve leksikologjike, e pastaj është analiza statistikore, fjalorthin e termave dhe në fund përfundimin dhe literaturën e shfrytëzuar. Ky studim gjuhësor, urojmë të jetë një ndihmesë për studiuesit e gjuhës shqipe, për ekspertët e kësaj dege pra të etnolinguistikës dhe për dashamirët e gjuhës shqipe.

## **Lënda e hulumtimit**

Për të trajtuar lëndën e krijuar nga ana etnolinguistike na u deshën një sërë njohurish, qoftë nga ana letrare apo nga ajo gjuhësore. Për t'i dhënë formën e merituar këtij punimi përdorëm si lëndë të parë veprat që kemi përzgjedhur të autorit në fjalë, por për t'i dhënë një formë edhe sa më shkencore punimit, përdorëm literaturë të pasur që kanë botuar ndër vite, për krijimtarinë e këtij autori.

## **Qëllimet e hulumtimit**

Qëllimi i këtij hulumtimi është të studiohet vepra e Fatos Kongolit edhe në aspektin e raportit mes gjuhës dhe popullit, gjegjësisht me kulturën materiale dhe shpirtërore, mentalitetin dhe krijimtarinë popullore, vepra e tij do të studiohet edhe në karakterin leksikologjik prandaj lirisht këtë studim mund ta quajmë studim interdisiplinar. Veprat e tij janë të stërmbushura me elemente etnolinguistike gjë që të bën t'i hyjsh më thellë këtij hulumtimi mjaft me interes për studiuesit e gjuhës. Në brendi veprat e Fatos Kongolit janë përplot me biseda të ndryshme popullore, materiale dialektore, folklorike, arkaike etj. Këtu kemi të bëjmë me kulturën tradicionale të popullit shqiptar ku hyjnë: bisedat e përditshme, histori të ndryshme, rrëfime, punë të përditshme, këngë popullore, përralla, proverba, poezi, përshendetje, doke, zakone, tradita, mallkime, urime, studime onomastike si: nofkat, emrat, mbiemrat, toponimet si dhe studime leksikore si: homonimet, sinonimet, historizmat, dialektizmat, arkaizmat etj.

## **Hipotezat**

Me këtë studim ne kemi parashtruar disa hipoteza të cilat mund të vërtetohen ose mohohen:

Hipoteza e parë: Mundësitë e hulumtimeve etnolinguistike në veprat e Fatos Kongolit janë të shumta.

Hipoteza e dytë: Njësitë frazeologjike (fjalët e urta, eufemizmat, urimet, mallkimet popullore, historizmat, arkaizmat, fjalët e huaja etj.), në veprat e Fatos Kongolit janë mjaft produktive.

Hipoteza e tretë: Huazimet, arkaizmat etj., në veprat letrare të Fatos Kongolit janë në funksion të poetikës së veprës letrare të tij.

## **Metodologjia e hulumtimit**

Për realizimin e këtij punimi ne ndiqëm këto faza pune:

1.Njohja e thelluar me autorin dhe veprën e tij që nuk janë të studiuara në aspektin etnolinguistik;

2.Hulumtimi dhe grumbullimi i materialit;

Fazat e kërimitFaza përgatitore

Studimi i literaturës

Leximi i veprave

Formulimi i platformës studimore

Faza e mbledhjes të të dhënave

1. Materiale etnolinguistike

2.Materialet leksiko-frazeologjike

3. Materiale sociolinguistike

Shqyrtimi i të dhënave dhe analiza e tyre

Përqasja me studime të mëparshme, duke plotësuar analizën për vepra të tjera të pa hulumtuara;

Analiza e veçorive etnolinguistike, duke e parë në vështrim përqasës me punime të mëparshme në këtë fushë;

Analiza e veçorive sociolinguistike të frazeologjisë, duke e parë në vështrim përqasës me punime të mëparshme në këtë fushë;

4.Analiza e veçorive leksikore, duke e parë në vështrim përqasës me punime të mëparshme në këtë fushë;

Shqyrtime të thelluara dhe mbështetëse për veprat e Fatos Kongolit;

Përgjithësime dhe përfundime.



## **Metodologjia e kërkimit**

Duke u nisur nga qëllimi i punimit, metodologjia e kërkimit u mbështet në shqyrtimin etnolinguistik dhe leksikor të veprave të Fatos Kongolit duke ndjekur dy drejtime:

1. Së pari, leximi në përgjithësi i veprave të Fatos Kongolit, si dhe literaturës hulumtuese për këto vepra, nxjerrja e materialit të nevojshëm për hulumtim
2. Së dyti, shqyrtimi i materialit faktik mbi bazën e literaturës teorike për të dhënë një pamje të plotë leksiko-frazeologjike, sociolinguistike dhe etnolinguistike të gjuhës së përdorur të Fatos Kongolit në veprat e tij.

## **Rëndësia e punimit**

Hulumtimi “Analizë etnolinguistike në disa vepra të Fatos Kongolit”, deri sot nuk i është dhënë rëndësi dhe nuk është hulumtuar në sasi të mjaftueshme mund të themi se ky hulumtim është për herë të parë në aspektin etnolinguistik. Pikërisht për këtë, ky hulumtim ka vlerë të madhe gjuhësore, etnolinguistike, leksikore, sociolinguistike.

Meqë, kemi mungesë të studimeve për këtë çështje, pra për studimin gjuhësor të veprave të Fatos Kongolit, pamë të arsyeshme që të hulumtojmë këtë temë me qëllim që të ju shërbej studiuesve tjerë që do të merren me këtë problematikë.

Synimi ynë kryesor i këtij punimi është që të realizojmë analizën etnolinguistike në disa vepra të Fatos Kongolit duke i shpjeguar ato dhe duke e mundur të jepnim ndihmën tonë modeste në fushën e etnolinguistikës shqipe, të çelur herët nga figura të shquara të shkencës sonë. Në këto vitet e fundit ka një “heshtje gjuhësore” për Fatos Kongolin; studimet gjuhësore mbetën jashtë vëmendjes kurse në aspektin etnolinguistik besoj se do të jem një ndër studiuesit e parë që do të sjell në dritë një punim të tillë shkencor. Ndaj, studimi ynë, është një detyrë e vështirë shkencore dhe një kënaqësi e madhe në të njëjtën kohë.

Përmes këtij studimi dëshirojmë fortë që të përmbylim një boshllëk në këto lloj studimesh për shkrimtarë të veçantë, por edhe të krijojmë hulli orientuese dhe hapësira të reja, që presin për t’u mbushur më tej, prej nesh ose prej të gjithë atyre që kërkojnë të merren me veprën e Fatos Kongolit. Jemi ndalë edhe tek njësitë frazeologjike dhe fjalët e urta në vepër, duke nxjerrë kështu veçori të gjuhës së veprës së Fatos Kongolit. Fatos Kongoli në veprën e tij ka përdorur me mjeshtëri shumë njësi frazeologjike, sepse frazeologjia gjuhësore, sidomos ajo popullore, është pjesë e pandarë e formës së shprehjes artistike, njësoj siç është leksiku dhe

sintaksa.Fjalët e huazuara do të jenë të pranishme në veprat e Kongolit si ato: turke, sllave etj.

## **Jeta dhe vepra e Fatos Kongolit**

Fatos Kongoli është nga Elbasani, ai lindi më 12 janar të vitit 1944 dhe sot njihet si një ndër shkrimtarët më të rëndësishëm shqiptar të pas viteve '90. Kongoli ka studiuar për matematikë, një pjesë të studimeve në Pekin dhe një pjesë të studimeve në Tiranë. Për një kohë të gjatë ka punuar si gazetar letrar dhe redaktor në Shtëpinë Botuese "Naim Frashëri". Është autor i një numri të madh veprash ku do të përmendim "Lëkura e qenit", "Dragoi i fildishtë", "Ëndrra e Damokleut", "I humburi" e shumë të tjerë, të cilët janë përkthyer edhe në Francë, Itali, Gjermani, Zvicër etj. Në romanet e tij përshkruan dramën ekzistenciale të njeriut modern.Fatos Kongoli është ndër shkrimtarët e shquar shqiptarë, jo vetëm brenda kufinjve të Shqipërisë, por dhe jashtë trojeve të saj. Fitues i disa çmimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, ai ka marrë titullin e lartë në Francë, "Kalorës i Legjionit të Nderit", akorduar nga presidenti francez, Sarkozy.Në një intervistë me Fatos Kongolin e intervistuar nga Kozeta Zylo, publikuar më 24.08.2010, Intervista është botuar në gazeta "Illyria" në New York, SHBA,i pyetur se në prozën tija ka momente që ka shprehur botën e tij personale dhe si, konkretisht? Fatos Kongoli thotë : ‘‘Pa dyshim, në të gjithë librat e mi ka elemente të jetës sime. Duke u nisur nga fakti që te një pjesë jo e vogël e tyre edhe rrëfimi bëhet në vetën e parë, lexues të ndryshëm në Shqipëri dhe jashtë, më kanë drejtuar shpesh edhe pyetjen nëse ato janë romane autobiografikë. Po marr si shembull romanin "Dragoi i fildishtë", ku personazhi kryesor, në rini të vet, ashtu si unë, ka studiuar në Kinë. Përveç këtij fakti aty ka shumë ngjarje, personazhe të ndryshëm etj, në përgjithësi hollësira, të cilat një njeri që më njeh nga afër dhe është në dijeni të ngjarjeve të jetës sime, do ta shtynin të më thoshte: po, ky është vërtet një roman autobiografik. E megjithatë nuk është kështu. Në këtë pikëpamje do të thoja se disa romane të mi janë dhe nuk janë autobiografikë. Sepse letërsia nuk mund të mbetet te fakti, te "historia", ajo shkon përtej tyre.’’

## **KREU I PARË SHQYRTIME TEORIKE**

### **Etnokultura**

Për popullin shqiptar, për jetën dhe kulturën e tij është shkruar edhe në të kaluarën. Autorë të ndryshëm në shkrimet e tyre, krahas njoftimeve të përgjithshme kanë lënë edhe të dhëna me karakter etnokulturor. Disa nga autorët: Frang Bardhi, Pjetër Budi, Pjetër Bogdani, Sami Frashëri, Thimi Mitko etj. Përveç autorëve shqiptarë janë marrë edhe autorët e huaj si: Pikëvilli, Ami Bue, G.Hahn, Hekardi, Nopça, Durhami, Haberlandti, të cilët kanë trajtuar problem të shumta entokulturore.

#### **a. Nofkat**

Nofkat janë emra familjarë ose humoristikë që u vihen personave ose dhe sendeve në vend të emrave të tyre të vërtetë. Nofkat mund të jenë hipokoristike (nofka përkëdhelie për të shprehur afërsinë ose lidhjet me personin që po cilësojmë). Nofkat e ashtuquajtura zvogëluese përdoren edhe këto për të shprehur afërsi apo familjaritet. Një pjesë e madhe e nofkave janë fyese dhe ofenduese. Nofkat nuk zgjidhen, ato u adresohen personave pa miratimin e tyre dhe nuk përdoren gjatë komunikimit të drejtpërdrejtë si emër përcaktues për folësin. Si koncept, nofkat duhet të dallohen nga pseudonimet apo titujt. Sipas FGJSSH (1980) “nofka është emër i dytë që i vihen dikujt për tallje, për shaka apo përkëdheli duke u nisur nga ndonjë e metë fizike a ndonjë tipar dallues”, ndërsa sipas Qemal Muratit “Turlitava gjuhësore ballkanike përmes ofiqeve dhe nofkave na flet qartë për psikologjinë dhe etnografinë e të folurit të popujve përkatës. Si shprehje e një arkaizmi provincial ata kanë krijuar një mal nofkash në gjuhët e tyre” (Murati, 2012, f. 351). Nofkat priren të lidhen me karakteristikat fizike të përdoruesve, të tilla si pesha, gjatësia ose ngjyra e flokëve të tyre ose me zakonet dhe tiparet personale të përdoruesve, shpesh zotësia ose mungesa e tyre. Nofkat janë ato grupe emrash joformalë të cilët përveç emrave kryesorë i shtohen një personi. “Kur bëhet fjalë për nofkat, ju duhet vërtetë një instinkt i sigurt”, thotë psikologjia e Parship, Dania Schifitan. Është e rëndësishme të kontrolloni nëse emri është marrë me të vërtetë nga personi tjetër ashtu siç e kuptoni ju. Schifitan: "Fazat e jetës ndryshojnë dhe bashkë me to ndoshta edhe kuptimi dhe qëllimi i një nofke".

## **b. Eufemizmat**

Eufemizmat shpesh mund të gjenden në tabutë sociale që nuk duhen përmendur në mënyrë eksplicite. Në vend të kësaj, ato janë eufemizma të parafrazuar. Megjithatë, eufemizmat mund të shërbejnë edhe për të errësuar faktet. Kur dikush ka vdekur, shpesh dëgjon fjalë si ndërroi jetë, humbi jetën. Shumica e njerëzve në këtë situatë shmangin termin e drejtpërdrejtë "vdes" dhe përpiqen të zëvendësojnë fjalën e pakëndshme me një tjetër - një eufemizëm. Termi "eufemizëm" rrjedh nga fjalët e lashta greke eu (i mirë) dhe femein (të flasësh, të thuash). Së bashku ata përbëjnë kuptimin "të thuash diçka të pakëndshme me fjalë të këndshme". Në të njëjtën kohë, ky është edhe funksioni i pajisjes stilistike. Gjuhëtarët i janë përkushtuar kësaj teme gjuhësore-etnografike për shumë dekada, duke e shpjeguar eufemizmat si një strukturë gjuhësore, duke i studiuar për nga forma e brendshme: çfarë na tregon ta përdorim atë, a gjendet në mënyrë të tërthortë; çfarë shkakton tek marrësi dhe çfarë duam të arrijmë me të. Sipas prof. Çabejt "Ata (eufemizmat) kanë vlerë mbasi nëpërmjet tyre ne njihemi me historitë e popujve të ndryshëm, me lashtësinë, veçoritë kombëtare, shkallën e zhvillimit, kushtet ekonomike, doket, zakonet. Ato lidhen me mitet dhe besimet me burim vendas dhe janë shprehje e ruajtjes së veçorive kombëtare të popujve. Këtu pasqyrohet më së miri të folurit e figurshëm të gjuhës popullore. Eufemizmat janë dukuri gjuhësore e përditshmërisë sonë, të cilat edhe pse mendohej se u përkasin kohëve të vjetra jo vetëm që nuk kanë shteruar, por po shtohen me sajesa a formime të reja. Eufemizmi është një figurë që zbut realizimin e disa ideve apo fakteve dhe që si antifraza bën që një fjalë apo shprehje të përdoret me një kuptim të ndryshëm nga ai që ka në realitet. Duke qenë se eufemizmat me përkufizim janë fjalë ose shprehje të stërholluara, të zbutura apo të zgjedhura me marrëveshje në mënyrë të logjikshme mund të mendojmë se kuptimi i tyre i vërtetë mund të jetë më i keq se ai i dukshmi (ai që shfaqet). Eufemizmat më shumë se çdo njësi tjetër gjuhësore janë të rrënjësura në ndërgjegjen kolektive, janë tregues dhe mishërues i plotë i lidhjeve të bartësve të gjuhës me truallin që u ka rënë për pjesë të ndajnë dhe janë dëshmi e gjallë e ndasive kohore, mendësore, kulturore që ata përcjellin. Prof. Shkurtaç ka pohuar se "Eufemizmat nuk janë vetëm dukuri e të folurit të njerëzve të moshuar, e grave pa shkollë, të atyre që mund t'i quanin të prapambetur e të tejkaluar. Jo, aspak, ato na ndjekin pas sot e gjithë ditën, ndonëse tashmë edhe me risime e përditësime të nevojshme" modernizuese". (Shkurtaç, 2004: 257)

### **c. Urimet dhe fjalët përkëdhelëse**

Urimi nuk është tjetër veçse një akt i të folurit që shpreh një qëndrim ndaj sjelljes dhe fatit të të tjerëve. Urimi është shprehja e një dëshire me fjalë, që pritët të realizohet në një kohë të ardhshme. (Coulmas 1981:154). Urimi mund të shprehet me shumë lloje formulash rituale që ndryshojnë sipas ndjenjave dhe situatave (Shkurtaaj 2001:77). Përsëritja në përgjithësi është shprehja gjuhësore paraprake apo e zanafillës për çdo ndërshkëmbim kulturor: ajo pasqyron një traditë të lashtë sa vetë njeriu, d.m.th. të drejtuarit me fjalë dhe nisjen e një komunikimi të vërtetë midis dy vetave; ajo është pikënisje për komunikimin, prandaj ka edhe një funksion të rëndësishëm gjuhësor (Arcuri 2000, 135-162). Urimet janë pjesë e ndërveprimit shoqëror dhe tregojnë atë që duam të shprehim. Por ato janë më shumë se thjesht fjalë të bukura dhe gjeste të këndshme: Urimet janë një shenjë solidariteti, miqësie dhe vlerësimi. Urimet janë gjithmonë pozitive dhe përmbajnë, lëvdata, komplimente, përshkrimin më të bukur dhe përvoja të përbashkëta. ‘‘Urimi shpreh një qëndrim ndaj sjelljes dhe fatit të të tjerëve pra ne e themi me fjalë. E shprehim një dëshirë me fjalë, që pritët të realizohet në të ardhmen.’’ (Coulmas 1981:154). ‘‘Urimi mund të themi se shprehet në shumë lloje rituale që ndryshojnë sipas ndjenjave që kemi dhe situatave që ndodhemi.’’ (Shkurtaaj 2001:77). Kur diçka e mirë i ndodh një personi, është e zakonshme që të tjerët të shprehin pozitivisht idetë dhe ndjenjat e tyre për të. Në një situatë të lajmeve të lumtura, folësit më së shumti përpiqen të tregojnë lumturinë e tyre duke thënë ‘‘urime’’, megjithatë, modelet dhe shprehjet që përdorin për të shprehur urimet mund të ndryshojnë në situata të ndryshme. Urimi klasifikohet si një akt shprehës i të folurit me të cilin folësi shpreh ndjenjat dhe emocionet e tij drejt dëgjuesit. Është një akt që është i dëshirueshëm për personin që ka arritur diçka, duke treguar atë lumturia e folësit. Kur dikush uron, ai/ajo tregon se ndan gëzimin e tjetrit.

Fjalët përkëdhelëse – Në fjalorin e gjuhës shqipe shpjegohet kështu: ‘‘Fjalët përkëdhelëse kanë ngjyrim zbutës e të dashur; ato shprehin përkëdhelje ndaj atyre që duam. Poashtu shprehin dashuri ose dashamirësi për të tjerët; poashtu ato shprehin ëmbëlsi, afërsi e butësi.

### **d. Mallkimet popullore**

Gjuha popullore veçohet për kuptimin e thënies, që vijnë nga studimi i rrethanave në të cilat kryhet biseda, përdoren gjeste e mimika, veçohet ritmi i shpejtuar, fjalitë janë më të shkurta, folësit ndjehen më të afërt. Mallkimet popullore si shfryrje e mllëfit dhe shkarkimit shpirtëror të thëna përmes fjalëve - si forcë magjike, përdoren nga të gjitha shtresat

popullore, duke filluar prej plakave dhe pleqve e deri te fëmijët. Mallkimet ekzistojnë në çdo gjuhë, e çdo popull. Mallkimet ndryshojnë nga rajoni në rajon dhe nga kultura në kulturë. Mallkimet kanë ekzistuar për aq kohë sa ka ekzistuar njerëzimi. "Mallkimet janë paraqitur moti kohë si një rezultat i mungesës së aftësisë së shpjegimit të shumë fenomeneve natyrore siç ishin krijesat e paramenduara, si shtrigë, lugat, kuçedër etj. Mosdituria ka bërë që frika prej këtyre fenomeneve të shtohet gjithmonë e më shumë. Njeriu kishte bindjen se këto krijesa të paramenduara kanë aftësi dhe forcë, për të bërë çdo gjë. Prandaj njeriu është frikuar nga këto krijesa por më pas është frikuar edhe nga mallkimet. Kështu mallkimet janë bërë armë për tu mbrojtur të dobëtit dhe ata të pambrojturit për t'iu kundërvuar më të fuqishmit sepse mundësi tjetër nuk kanë pas. Edhe pse thuhet se gratë mallkojnë më shumë por mallkimet paraqiten tek të dy gjinitë por ka dallime, gruaja përdor tjera e burri tjera por mallkimet përdoren te të dy gjinitë. Mallkimet janë pjesë e gjuhës popullore ato janë pasqyrim i gjendjes tonë emocionale pra këtu, flasim për gjendje të keqe, kur njeriu mendon se është i pafuqishëm, por që beson fuqishëm tek, fjalët e tij dhe se ato fjalë do të kthehen në veprime dhe do të bëhen realitet. Dëshira që këto fjalë të kthehen në fatkeqësi për të atë që mallkojmë tregon se ne e përdorimin vazhdimisht dhe e kemi si mënyrë dëshirore pra që ajo të ndodh." (Dodi, 2004, f. 193)

### **e. Ngushëllimet**

Fjalët dhe ndjenjat që shprehim për të ngushëlluar dikë kur i vdes një i afërm. Ngushëllimet ose shprehja e ngushëllimit është si për burrat ashtu edhe për gratë por nuk përdoren të njëjtat. Kur vdes dikush thuhet se atyre u ka ardhur ajo që i shpërqendron ata, domethënë vdekja. Familjarët dhe miqtë janë të pikëlluar dhe të paafte për të kryer detyrat e tyre të zakonshme. Sjellja e duhur është ngushëllimi i familjes së të ndjerit. Po ashtu kemi fjalë që shprehim ngushëllime.

### **f. Ofendimet (sharjet)**

Për fat të keq gjithmonë ka njerëz që kënaqen duke ofenduar, apo provokuar të tjerët. Të sharat janë spontane dhe ndihmojnë të largojnë nervozën në moment po ashtu kanë ekzistuar aq kohë sa ekziston njerëzimi.

## 2. Onomastika

Onomastika është një degë e gjuhësisë dhe siç shihet vetëm nga terminologjia, merret me studimin e emrave si psh: emrat e vendeve, emrat e njerëzve, merret me kuptimin e tyre, prejardhjen e emrave dhe shtrirjen e tyre. Termi onomastikë rrjedh nga fjala greke »onoma«, që do të thotë diçka si »emër. Fokusi është se çfarë pronash kanë emrat, si janë zhvilluar, çfarë shprehin dhe në çfarë mase janë të shpërndarë nëpër botë. Shqyrtohen emrat dhe mbiemrat, por edhe emrat gjeografikë si emrat e vendeve apo lumenjve.

Shkenca që studion emrat në të gjitha aspektet e tyre quhet onomastikë. Tema e kësaj shkence është e gjerë sepse pothuajse çdo gjë mund të ketë një emër dhe sepse studimi i emrave teorikisht përfshin të gjitha gjuhët, të gjitha rajonet gjeografike dhe kulturore dhe të gjitha epokat historike. Megjithatë, në një përdorim më të lirë, termi onomastikë përdoret për emrat vetjakë dhe studimin e tyre dhe termi toponimi përdoret për emrat e vendeve dhe studimin e tyre. Vetë termi toponimi mund të kuptohet në dy mënyra, madje edhe në terminologjinë e saktë: ose merret në mënyrën më të gjerë të mundshme duke përfshirë vendet e banuara, ndërtesat, rrugët, vendet, malet, lumenjtë, liqenet, oqeanet, yjet, etj. , ose është i kufizuar në vende të banuara (qytetet, qytezat, fshatrat, fshatrat).

### a. Emrat e banimit dhe tempujve

Emrat janë pjesë të rëndësishme të shoqërisë tonë, sepse ato janë të lidhura me identitetet njerëzore, të vendit dhe kështu mund të ndikojnë në nocionet mjedisore të identiteteve dhe marrëdhënieve me njëri tjetrin - gjithashtu në nivelin makro në një shoqëri. Emrat janë fjalë që përshkruajnë objekte, koncepte, kafshë, njerëz ose bimë. Me emrat ju përshkruani gjëra që mund të perceptohen me shqisat (pemë, skunk) ose të sajuara, por që konsiderohen të ekzistojnë (zanë, shtojzovalle). Shumë autorë në veprat e tyre kanë përdorur emra të vendlindjeve të tyre pra fshati nga e kishin prejardhjen. Këta emra janë shumë të vjetër dhe kanë historinë e tyre , të cilat ishin bartur brez pas brezi deri në ditët e sotme. Emrat e banimit dhe vendeve kanë luajtur një rol të rëndësishëm si në jetën shoqërore po ashtu edhe në atë letrare. Burim frymëzmi i çdo autori ka qenë vendlindja e tij fshati nga ka pas origjinën. Vendin më kryesorë e kishin fshatërat e malësive ku jetonte dhe vepronte populli shqiptar. Emrat janë shpesh e vetmja dëshmi e mbijetuar e etnive, gjuhëve dhe kulturave të mëparshme. Prandaj, emrat e vendeve janë një burim jashtëzakonisht i rëndësishëm për ata që studiojnë historinë e vendbanimeve, kulturës dhe gjuhës së një rajoni.

**TEMPULL***m.* Tempujt kanë qenë gjithmonë vende që janë rezervuar për aktivitete që konsideroheshin të shenjta. Tempulli është një ndërtesë e ndërtuar për rituale dhe ceremoni të shenjta dhe e dedikuar vetëm për këtë qëllim. Fjala tempull nënkupton shtëpinë e Zotit. Ndërtesa të tilla janë ngritur në shumë epoka të ndryshme, si nga idhujtarët, ashtu edhe nga adhuruesit e Zotit. Pjesa e jashtme e këtyre tempujve përdorej për tubime dhe ceremoni publike, por gjithmonë ekzistonte një zonë e brendshme, e qasshme vetëm për priftërinjtë, e cila thuhej se shfaqte praninë e hyjnisë. Tempulli nuk është konsideruar kurrë si një vend për tubime të zakonshme publike, por si një zonë e shenjtë e rezervuar për ceremonitë më solemne të adhurimit të perëndive. Lloji më i rëndësishëm dhe më i përhapur i ndërtesës në Greqinë e lashtë ishte tempulli. Tempujt e parë prej guri u shfaqën diku në fillim të shekullit të 6-të para Krishtit dhe u shfaqën në numër të madh gjatë shekullit të ardhshëm. Qëllimi i një tempulli ishte zakonisht të vendoste një statujë ose emblemë kulti. Tempujt ishin kryesisht monumente të perëndive. Edhe në letërsinë shqipe këta tempuj, faltore janë mitizuar dhe ishin bërë të pavdekur. Si shembull Mali i Tomorrit është një tempull hyjnor dhe mitik, sepse aty gjenden kulmet, shkëlqimi i lavdisë dhe i madhështisë së gjenezës sonë si popull.

## **b. Emrat dhe mbiemrat si shenjë identiteti**

Emri, është një tipar identiteti. Me emrin, çdo person përshtatet në shoqëri dhe identifikohet si person. Emrat pasqyrojnë identitetin ose personalitetin e dikujt. Emrat janë një element i formuluar gjuhësor, funksioni kryesor i të cilit është të rregullojë identitetin e njerëzve. Emrat ato pasqyrojnë identitetin ose personalitetin e dikujt. Prandaj, emrat nuk janë vetëm vlerësime apo preferenca shijesh nga personat prej të cilëve i kemi marrë, por shërbejnë edhe për identifikimin e bartësit të emrit. Strauss e përshkruan marrëdhënien midis emrit dhe identitetit si "lidhja e pathyeshme midis emrit dhe imazhit të vetvetes". Mbiemrat janë një emër trashëgues i një njësie familjare të ndarë nga anëtarët e saj. Shumë mbiemra rrjedhin nga emrat personalë, profesionet, emrat e vendeve, karakteristikat ose ngjarjet me rëndësi historike për familjet. Emrat e përveçëm janë emërtime që përdoren për të identifikuar entitete të veçanta individuale (një person, një vend, një vend, një institucion, etj.). Shumë prej tyre janë emra të thjeshtë, të përbërë ose të prejardhur, për shembull Saranda, Vjenë, Gjermani, Evropë, Amerikë Jugore, Maqedonia e Veriut. Ato shkruhen me shkronjë të madhe sipas. Ekzistojnë gjithashtu emra të përveçëm shumëpjesësh që shpesh përmbajnë edhe komponentë jo thelbësorë, për shembull Kepi i Shpresës së Mirë, Lajmet e fundit të Maqedonisë së Veriut, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.



Në emrat e përveçëm përfshihen:

- 1.Emrat dhe llagapet e njerëzve, pseudonimet: Arta, Irma, Gent,Adreni.
- 2.Emrat e kafshëve: Bizoni, Antilopa;
- 3.Emrat gjeografikë:Jon,sheshi’’Zahir Pajaziti’’;
- 4.Emrat e periudhave dhe ngjarjeve historike: Kongresi i Drejtshkrimit;
- 5.Emrat e institucioneve, të organizatave, të ndërmarrjeve etj.: Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit, Ministria e Shëndetësisë;
- 6.Titujt e veprave letrare, të gazetave e të revistave: “Lulet e verës”, “Vargjet e lira”, “Zëri i popullit”.
- 7.Emrat e trupave qiellorë: Dielli,Toka,Hëna etj.

### 3. Leksikologjia

Leksikologjia merret jo vetëm me fjalët e thjeshta në të gjitha aspektet e tyre, por edhe me fjalët e ndërlikuara dhe të përbëra, njësitë kuptimore të gjuhës. Meqenëse këto njësi duhet të analizohen si nga forma ashtu edhe nga kuptimi i tyre, leksikologjia mbështetet në informacionin e marrë nga morfologjia. Në përgjithësi mund të themi se leksikologjia është një shkencë gjuhësore, ose nëndisiplinë e gjuhësisë, që merret me studimin e fjalorit ose leksikut, pra morfemave dhe fjalëve në përgjithësi. Leksikologjia ka të bëjë edhe me marrëdhëniet ndërmjet fjalëve.

“Në periudhën para viteve ’40 të atij shekulli janë bërë hapa me rëndësi në kërkimet leksikologjike, sidomos për të nxjerrë në dritë pasurinë leksikore e frazeologjike të shqipes, për ta pastruar atë nga lënda e huaj dhe për ta pasuruar me njësi e krijime prej brumit të vet”. Leksikologjia është degë e gjuhësisë që studion fjalët. Një fjalë është njësi më e vogël kuptimplote e një gjuhe që mund të qëndrojë më vete. Ajo përbëhet nga përbërës të vegjël të quajtur morfema dhe elemente edhe më të vegjël të quajtur fonema ose veçori dalluese.Leksikologjia studion të gjitha karakteristikat e një fjale - duke përfshirë formimin, origjinën, përdorimin dhe përkufizimin. Leksikologjia merr në konsideratë edhe marrëdhëniet që ekzistojnë midis fjalëve.Në gjuhësi, leksiku i një gjuhe përbëhet nga leksema, njësi kuptimore abstrakte që korrespondojnë me një grup formash të lidhura të një fjale. Leksikologjia studion se si mund të zbërthehen fjalët dhe identifikon modelet e përgjithshme, të cilët ndjekin. “Leksiku dhe frazeologjia shqipe vlerësohen si pasuri kulturore e përbashkët kombëtare, që duhet mbledhur e studiuar me synimin që të shërbejë

për zhvillimin e gjithanshëm të shqipes standarde, për ta bërë këtë gjuhë sa më të fuqishme e më shprehëse”. (Thomai 2006:15)

### **a. Fjalët e urta**

Fjalë të urta ka në çdo gjuhë dhe në çdo kulturë pra janë pjesë përbërëse e çdo gjuhe! Fjalët e urta janë shekullore ose mijëvjeçare. Një fjalë e urtë është një thënie dhe ato janë kryesisht udhëzuese dhe kuptimplota. Fjalët e urta janë një pjesë e rëndësishme e gjuhës së përditshme, por gjithashtu përdoren shpesh në vepra e tekste. Kuptimi i fjalëve të urta mund të jetë gjithashtu mjaft i çuditshëm ndonjëherë. Për t'i deshifruar ato duhet të ketë njohuri të gjuhës, më saktë, një fjalor të saktë. Një fjalë e urtë është një figurë e të folurit që përdoret vazhdimisht. Fjalët e urta të panumërta janë shumë të njohura, saqë shpesh mund të dëgjohen në gjuhën tonë të përditshme. Shumica e fjalëve të urta vijnë nga përvojat e jetës që shumë njerëz kanë gjatë gjithë jetës së tyre. Meqenëse fjalët e urta bazohen kryesisht në përvojat e njerëzve, ato nuk kanë autorë të veçantë siç është rasti me citimet. Një fjalë e urtë është një shprehje që përmban një mençuri të jetës. Çdo popull dhe çdo gjuhë ka një mori fjalësh të urta. Ne i përdorim këto çdo ditë, pa e kuptuar fare, shpesh pa e ditur se nga vjen. Fjalët e urta përkufizohen si thënie ose gjykime të njohura që përdoren shpesh dhe nga shumë njerëz. Fjalët e urta shprehin një mendim popullor ose përvojë të përgjithësuar brezash të ngjeshur si urtësi popullor. Ato janë në formën e një fjalie të pavarur që nuk kërkon përshtatje dhe plotësim sipas kontekstit. Fjalët e urta janë thesari i çdo populli. Ata kapin përvojat e jetës dhe mençurinë e gjeneratave të mëparshme dhe na mësojnë vlerat etike dhe njerëzore. Ata kanë bazat e tyre në jetën dhe kulturën e çdo populli dhe përmbajnë një të vërtetë të jetës. Fleischer e përshkruan fjalën e urtë si më poshtë: "Fjalët e urta janë ndërtime të fiksuara fjalish me një prirje didaktike që i referohet jetës praktike". Për qëllimet që kemi ne, është e rëndësishme të themi se, fjalët e urta përgjithësisht konsiderohen bashkime speciale frazeologjike. Fjalët e urta shfaqen në shumë popuj si "rutinë në bisedë" dhe për këtë arsye përcaktojnë mënyrën e të folurit.

### **b. Njësitë frazeologjike**

Frazeologjia - përbërja frazeologjike e gjuhës, si dhe pjesa e gjuhësisë që studion atë. Njësia themelore e frazeologjisë është njësia frazeologjike - një kombinim i qëndrueshëm i fjalëve. Në shumë aspekte, njësitë frazeologjike janë më afër një fjale sesa një fjalie, prandaj ato studiohen në lëndën e leksikologjisë. Frazeologjia ka karakter më të gjerë ndërdisiplinor,

pasi njësitë frazeologjike studiohen nga disa këndvështrime: leksikore, sintaksore, stilistike, semantike, duke pasur edhe lidhje me etimologjinë. Nevoja për t'u marrë me njësitë frazeologjike në fjalorë do të thotë se për to kujdeset edhe leksikografia. Frazelogjia gjithashtu ka lidhje me pragmatikën, sociolinguistikën, psikolinguistikën dhe madje edhe kulturën në përgjithësi. Sipas shumë studiuesve, njësitë frazeologjike janë kombinime leksikore, kuptimi i të cilave përcaktohet nga shprehja. Tipari më dallues i njësive frazeologjike është shprehja emocionale dhe konciziteti i shprehjes së mendimit. Duhet theksuar se njësitë frazeologjike pasqyrojnë kulturën dhe një mentalitet kombëtar të një kombi të caktuar. Njësitë frazeologjike janë pjesë përbërëse e çdo gjuhe ose kulture dhe njohja e këtyre njësive dhe interpretimi i duhur i tyre është dëshmi e përkthimit të duhur të të gjithë shprehjes ose të një vepre arti.

Shënimet e para të frazeologjisë shfaqen në fund të shekullit të 19-të në veprën e gjuhësisë së përgjithshme, me referenca nën emra të ndryshëm për atë që në këtë artikull titullohet njësia frazeologjike. “Njësitë frazeologjike dëshmohen jo vetëm në gjuhën e folur si të lashta, po edhe me shkrim, që me dokumentet e para shqip, shpesh herësi formime më të hershme se njësitë leksikore sinonime me to.” (Thomai 1981:2) Në gjuhësinë shqiptare interesimi për frazeologjinë ka lindur që herët nga vitet e 30 të shekullit të shkruar duke vazhduar deri në ditët tona. Këtu mund të përmendim si Aleksandër Xhuvani (1921), Justin Rrota (1942), Mahir Domi (1985), Jani Thomai (1981), etj. Te “Leksikologjia e gjuhës shqipe” (2006), theksohet se “Njësia frazeologjike është njësigjuhësore me kuptim të mëvetësishëm, e përbërë nga dy ose më shumë fjalë shënjuese, me gjymtyrë e ndërtim të qëndrueshëm, e formuar historikisht e për një kohë të gjatë, që ka vlerën e një fjale të vetme, që riprodhohet e funksionon në ligjërim si njësi e gatshme dhe e pandashme”. Kjo nënkupton që struktura e saj mund të shkojë deri në strukturë fjalie me kusht që siç nënvizohet te “Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe” (1999) “në fushën e shqipes si tipare të përgjithshme të njësive frazeologjike janë njohur struktura togfjalëshore, njësia kuptimore, qëndrueshmëria, figurshmëria, neutralizimi i raporteve të brendshme sintaksore, njëvlerësia me fjalën nga ana e kuptimit kategorial dhe e funksionit në ligjërim”.

### **c. Dialektizmat**

Dialektizmi përkufizohet si tendenca e një individi për të kuptuar, toleruar dhe pranuar informacione ambivalente ose kontradiktore. Mendimtarët e lartë dialektologë prirën ta perceptojnë botën në fluks të tillë që paradokset dhe kontradiktat të lindin vazhdimisht. Si të tillë, ata besojnë se një argument mund të jetë i vërtetë dhe i rremë në të njëjtën kohë.

Dialektizmi, duke reflektuar të menduarit holistik sepse ndryshe mund të themi se është i rrënjosur. Justin Rrota i quan idjotizme. Ai bën këtë përkufizim: “Idjotizmet, qi quhen edhe provincializme, janë fjalë e mënyra së shprehurit, të përdoruna vetëm në ndonji dialektit, nëndjalekt a krahinë të vendit, të lanuna m’anesh prej shkrimtarësh të mirë, të cillat u largohen trajtavet të vërteta të gjuhës”. ( Rrota, 2006:17). Sterjo Spasse i përcakton kështu dialektizmat: “Krahas me gjuhën letrare gjendet edhe gjuha që flitet, ajo gjuhë në të cilën flet masa e gjerë e popullit. Të mos harrojmë se gjuha letrare formohet duke pasur për bazë gjuhën që flet populli. Por të gjitha fjalët që flet populli në krahina të ndryshme nuk mund të hyjnë në gjuhën letrare. Fjalë të tilla të përdorura ka nëpër dialektet e krahinave të ndryshme të një vendi dhe këto nuk janë bërë pronë e përgjithshme e tërë popullit. Këto lloj fjalësh quhen dialektizma ose provincializma”. (Spasse, 1964:29). Dialekt (nga greqishtja dialectos-talk, gjuha, gjuha popullore) është një lloj i të folurit, i karakterizuar nga uniteti relativ i sistemit (fonetik, gramatikor, leksikor) dhe përdoret si mjet komunikimi i drejtpërdrejtë në një ekip të vendosur në një zonë të caktuar të kufizuar. . Dialekti është pjesë e një formimi më të gjerë gjuhësor, duke u kundërvënë dhe duke ndarë të përbashkëta me pjesë të tjera të asaj tërësie, me dialekte të tjera. Ka dialekte shoqërore territoriale. Dialektizmat territoriale karakterizohen nga diferencimi shoqëror. Theksohet tipi tradicional i dialektit, i përfaqësuar më së shumti nga brezi i vjetër. Në letërsi përdoren shpesh fjalë nga dialekte të ndryshme për arsye stilistike (për të krijuar ngjyrë lokale, për të karakterizuar personazhet gjuhësore). Dialektizmat janë gramatikore. Veçoritë gramatikore në një dialekt të caktuar, të manifestuara në deklinion, formimin e pjesëve të të folurit, kalimin nga një gjini gramatikore në tjetrën. Dialektizmat (nga greqishtja dialectos- dialekt) janë tipare gjuhësore karakteristike për dialektet territoriale dhe të përfshira në gjuhën letrare. Dialektizmat janë gjithmonë në kontrast me gjuhën letrare. Ndërveprimi ndërmjet dialektit dhe gjuhës së thjeshtë përcakton aktualisht rrugët e zhvillimit të mëtejshëm dhe të zhvillimit të tyre. Dialektizmat u referohen fjalëve që nuk përfshihen në sistemin leksikor kombëtar, por që i përkasin një ose më shumë dialekteve të gjuhës kombëtare. Dialektizmat janë gjuhë e përditshme e të gjitha seksioneve të popullit të bashkuar nga një bashkësi territoriale. Dialektizmat e përdorur në letërsi perceptohen si të huaja për gjuhën letrare dhe zakonisht përdoren për qëllime stilistike artistike dhe shprehëse. Dialektizmat kanë veçori të caktuara që i dallojnë nga strukturat e zakonshme gjuhësore, p.sh. B. përdorim fonetik, morfologjik, fjalësh dhe përdorim fjalësh të panjohura për gjuhën letrare. Në varësi të këtyre veçorive, fjalët dialektore ndahen në disa grupe. Në “Fjalorin shpjegues të termave të

letërsisë” thuhet për dialektizmat: “Fjalë që përdoren vetëm në një krahinë e territor të caktuar dhe nuk i përkasin mbarë gjuhës.”

#### **d. Arkaizmat**

Ekziston një diskutim i pafund midis gjuhëtarëve, nëse arkaizmat përfaqësojnë elementin e nevojshëm të gjuhës, apo janë një prekje e stilit të modës së vjetër që nuk kryen ndonjë funksion të realizueshëm. Grupi i parë vë në dukje bukurinë e hollë të shumicës së fjalëve të vjetra ose antike. Arkaizëm vjen nga greqishtja *arkhaismos*=diçka e lashtë, e vjetër. Justin Rrota thotë për arkaizmat: “Thirren këso dore njato fjalë e mënyrë të përdoruna prej shkrimtarësh së hershëm e qi sod, nëpër njatë zhvillim, qi shkon tue ba gjuha, janë lanë m’anesha janë xëvendsue me tjera.” Arkaizmi është një fjalë që zhduket nga gjuha sepse nuk përdoret më dhe përgjithësisht perceptohet si e modës së vjetër. Nëse arkaizmat përdoren me vetëdije në retorikë, ato konsiderohen mjete stilistike. Një arkaizëm mund të përdoret në një mënyrë distancuese, ironike ose patetike, pra e ekzagjeruar dhe e mbivendosur. Arkaizmat i përkasin një kategorie fjalësh që kanë mbijetuar kundër të gjitha gjasave. Në Arkaizmat duhet të përdoren me vetëdije nga autori si mjete stilistike për t’u konsideruar fare si të tillë. Prandaj, ato konsiderohen tashmë arkaike kur shkruajnë një tekst dhe përdoren për të zhvilluar një efekt të caktuar. Arkaizmat përdoren ndonjëherë në ato vepra ku pasqyrohet e kaluara dhe në këtë rast ndihmojnë për të dhënë më me vërtetësi ngjyrën e kohës. Mjeshttrat e fjalës, në veprat artistike me karakter historik, kur përdorin arkaizma, i zgjedhin nga ato që kuptohen lehtë dhe e kufizojnë shumë numrin e tyre. Arkaizmat janë shembuj interesantë të evolucionit të vazhdueshëm të gjuhës, si dhe një dritare në të kaluarën. Arkaizmat i përkasin një kategorie fjalësh që kanë mbijetuar kundër të gjitha gjasave.

#### **e. Historizmat**

Historizmat janë pjesë e historisë, ato mund të studiohen për zhvillim, por nuk është e nevojshme t’i përdorim ato në gjuhë, të tjerët nuk do të jenë në gjendje të kuptojnë kuptimin e tyre. Historizmat janë përdorur për një kohë shumë të gjatë. Si psh - Pionier, Komunist, pushtet Sovjetik, Byro Politike. Ndonjëherë fjalët hyjnë në kategorinë e fjalorit të përgjithshëm: lice, shkollë e mesme, polici. Fjalë që shënojnë diçka që lidhet me ndonjë periudhë historike.

## **f.Huazimet**

“Një tipar i përbashkët që i shquan gjuhët e Ballkanit nga gjuhët e tjera indoevropiane të kontinentit, është edhe prania e një shtrese fjalësh të ardhura nga turqishtja, të cilat disastudiues i quajnë thjesht turqizma e disa orientalizma, meqë një pjesë e mirë e tyre janë meburim nga arabishtja e nga persishtja dhe turqishtja ka qenë vetëm gjuha ndërmjetëse.” (Lafe, nr.1-4, 1993) Depërtimii i huazimeve është bërë në periudhë të gjatë kohore dhe detyrimishtkanë hyrë në çdo sektor të jetës shqiptare.”Huazim quhet fjalë a njësi tjetër gjuhësore, që është marrë prej një gjuhe tjetër dhe përdoret në gjuhën amtare.” (Bakui, 2019) Për ta arritur këtë është bërë një punë shumëvjeçare nga autorë, studiues, gjuhëtarë e dashamirës të shqipes.

## KAPITULLI I DYTË

### ANALIZA ETNOLINGUISTIKE E VEPRAVE

#### VEPRA I

#### ROMANI “BOLERO NË VILËN E PLEQVE”

Një ndër romanet më të njohura të Fatos Kongolit, që paraqet realitetin shqiptar të viteve të fundit në gjuhën dhe letërsinë shqipe. “Një roman i ironisë dhe hidhësisë së trishtuar, romani i debatit emancipues.” – do të shprehej për këtë roman botuesja dhe shkrimtarja e njohur

Flutura

Açka.

Kritiku Mark Marku, me fjalën e tij, tha: “Romani i Kongolit reflekton botën moderne dhe i përshtatet asaj. “*Bolero në vilën e pleqve*” reflekton pjekurinë e letërsisë dhe romanit shqiptar. Është një libër mjaft interesant, që unë e kam lexuar me një frymë dhe më ka tërhequr shumë. Them se është romani tij më i mirë deri tani.”(2009)“*Bolero në vilën e pleqve*” me autor Fatos Kongoli.

Dy të moshuar, në një vilë dhe një infermiere që kujdeset për ta. Në aktin e fundit të jetës pra në ditët e fundit të jetës së tyre, të moshuarit i shkruajnë letra njëri-tjetrit, të cilat i zhdukin pa lënë asnjë gjurmë të vetme, ndërsa infermierja që kujdeset për ta përpiket më kot t'i shtjerë në dorë. Botën e mbyllur të vilës e trazojnë kohë më kohë doktori i familjes, njeri qejfli, hokatar dhe i paparashikueshëm, djali i të moshuarve, shef i një firme të fuqishme ndërtimi, me gruan e tij të re e të bukur; vajza e madhe e të moshuarve, gjyqtare e rreptë; një femër enigmatike, po aq e bukur, veshur gjithmonë me të zeza, etj. Duke na sjellë me këtë libër prozën e tij më të përkryer, Kongoli, përmes rrëfimit të infermieres, zbulon misteret e saj, dramat e personazheve, me ndërlikimet, dëshirat e fshehura, në një mjedis shpesh të egër, të pamëshirshëm, ku femra është më e pambrojtura. Një qasje ndaj ekzistencës njerëzore, që nuk e kemi hasur më parë në letrat shqipe. Bolero në vilën e pleqve" njihet si romani i krizës ekzistenciale. Në thelbin e tij ndërtohet mbi një kurth të padukshëm pra nuk shihet kurrë. Prania dhe kërcënimi i vdekjes për të moshuarit e vilës, në fakt, është kontrapunkti për vdekjen e gjallë të shërbestares së tyre, të karakterit qendror të veprës. Gjithkush që hyn e del në vilë me shqetësimin për fatin e të moshuarve që jetojnë në një komoditet dhe jetë luksoe, as që e vë re se ç'ndodh me vajzën, sikur ajo të jetë një njeri pa të shkuar dhe që zor ndokush mund t'ia parathotë të ardhmen. Ajo është një qenie

kalimtare në rrugën e tyre që duhet vetëm të vërë në lëvizje mekanizmin që i mban gjallë të vjetrit, të kujdeset për agjendën, oraret e ilaçeve, të të ngrënit, pse jo, të mbajë barometrin e humorit të tyre. Secili prej tyre ka vetëm një qëllim: të bëhet sa më i dukshëm në këtë krizë që ua kërcënon identitetin. Drama ka një "luftë të brendshme", elektricitet, gjendje e situata shpeshherë absurde, ka gjetje dhe zgjidhje shpesh befasuese. Letërkëmbimi i të moshuarve, këmbëngulja për të plotësuar zbrazëtitë dhe pengjet që koha ua mori, tensioni sikur është i lartë ose i ulët shpeshherë i shpikur në kërkim të më shumë vëmendje, janë mjetet me të cilat autori operon për të arritur tek idetë e tij. Edhe vetëperceptimi i personazhit kryesor qysh në krye të librit si "qenie me nivelin zero të zhvillim mendor", e parathotë tërmetin e ardhshëm të jetës së saj, një nga gjërat më të trishtuara që do të doje të lexoje për fatin e një gruaje, që mbyllet, siç edhe ka nisur, me vetminë e saj para pasqyrës dhe refuzimit të vetvetes. Në aspektin etnolinguistik është e mbushur me elemente të tilla të cilat i keni në këtë punim të doktoratës.

## **1. SHQYRTIME ETNOKULTURORE**

### **a) Përdorimi i nofkave**

Nofkat e mbledhura në romanin *"Bolero në vilën e pleqve"* të Fatos Kongolit janë këto: Binjakët, Zuska, Sharon Stoun, Mjeku i rojës, djemtë e lagjes, Miss Albania, Mis Shqipëria, Provokator i madh, Hipopotam, Gruaja me të zeza, kronistja e lajmit, Komik i madh, Komiku i madh amerikan, Mistifikatore naive, Kazanova, Shefi i pavijonit, Bashkëshorte arrogante, Ministri shtatshkurtër, Adoleshenti i përjetshëm, Grabitëse burrash të martuar.

### **b) Përdorimi i eufemizmave**

Si strategji të rëndësishme, ta quajmë etnolinguistike, autori Fatos Kongoli në romanin e tij përdor edhe eufemizmat, sepse gjuha pa eufemizma paraqet një mjet të dobët komunikimi. Eufemizmat e mbledhura në romanin *"Bolero në vilën e pleqve"* të Fatos Kongolit janë këto: Një kancer i egër që po e hante të gjallë-sëmundja e kancerit, Epoka e një dashurie megjullore, Amerikan i fillimit të shekullit të kaluar, të holla nën dorë, Një qenie në nivelin zero të zhvillimit mendor, Brezi i pishave, Marsi njerëngrënës 1997, Kohërat e qepës.

### **c) Përdorimi i urimeve dhe fjalëve përkëdhelëse**

Gjatë analizës së romanit *"Bolero në vilën e pleqve"* të Fatos Kongolit arrijmë të gjejmë edhe emra përkëdhelës, që në fjalor na jep këto shpjegime:



1. që përkëdhel, që shpreh dashuri a ëmbëlsi, i këndshëm, ledhatues: shikim përkëdhelës, fjalë përkëdhelëse.

2. *gjuh.* që ka ngjyrim zbutës a mirëdashës, që me trajtën e vet shpreh përkëdhelje a zbunim: emër përkëdhelës, prapashtesë përkëdhelëse. Në veprën "*Bolero në vilën e pleqve*" arritëm t'i gjejmë këto : I lumtë dora, U bëftë më e mira, Rrofsh ! Je top fare, E uroja fillimin e lojës, Uroje doktorin, ka vendosur të martohet.

### **ç) Përdorimi i mallkimeve popullore**

Gjuha e shkruar është konsideruar gjithnjë si një përçuese e vlerave të kulturës së një populli. Ndaj edhe krijimtaria e Fatos Kongolit, me një gurrë mjaft të pasur shprehjesh mund të studiohet nga pikëpamja e etnografisë së të folurit, për të parë se si janë ngërthyer gjuhësisht këto shprehje e me çfarë mjetesh është realizuar shprehja gjuhësore e personazheve të tij. Përkrah kulturës dhe traditës, shkrimtari Fatos Kongoli, në veprat e tij ka përdorur edhe mallkimet. Këto janë forma të të shprehurit të inatit, zemërimit të cilat gjejnë përdorim në të folurën popullore të përditshme. Gjatë analizës së romanit "*Bolero në vilën e pleqve*" të Fatos Kongoli arritëm t'i gjejmë këto mallkime popullore: Moj e mjerë, Ik e mallkuar, Besoj të ketë ngordhur, Më hëngërt mortja, Më rëntë një pikë, Ky vend është i mallkuar, Unë jam e mallkuar për vete, Do të ma bënte varrin, Të më bënin varrin, Meriton të ngordhësh si qene.

### **d) Përdorimi i ngushëllimeve**

Autori Fatos Kongoli, në veprat e tij ka përdorur edhe ngushëllime me të cilat përmes fjalëve ka shprehur dhimbjen e vdekjes. Gjatë analizës së romanit "*Bolero në vilën e pleqve*" të Fatos Kongolit arritëm t'i gjejmë këto ngushëllime që shprehen më shumë: Do të jepte shpirt, Shën Mëri , bëj që e mjera nëna ime të prehet e qetë atje ku ndodhet, Të rrugëtojë në paqe drejt mbretërisë së Zotit, S'është në dorën tonë, kështu ka qenë e shkruar, Të shkuara, të haruara, Për shpirtin e nënës.

### **e) Ofendimet (sharrjet)**

Përdorimi i gjuhës fyese, shantazhet, kërcënimet, përçmimet etj. kanë qenë të pranishme edhe në jetën e përditshme të popullit tonë me shekuj. Shkrimtarët shpesh në veprat e tyre

kanë përdorur edhe ofendime për ta reflektuar më mirë gjuhën e popullit por edhe për t'i dokumentuar ata. Në veprat e tij, Fatos Kongoli ka përfshirë shumë ofendime. Gjatë analizës së romanit *"Bolero në vilën e pleqve"* të Fatos Kongolit arritëm t'i gjejmë këto ofendime (sharrje): Femrat shqiptare, të bukura a të shëmtuara, të reja apo plaka, orvaten ose jo të vetëvriten me një nga mënyrat e njohura, janë kafshë të lodhura, ngordhalaqi, Horrat e lagjes, Vagabondi, Mos u bëj e trashë, Je një horr i paturpshëm,, mashtrues, langaraqë, kafshë, Bushtër, Bushtër e tërbuar, Kazan plehrash, kurvari, Shkërdhatë, Shushkë, Çfarë mutin do të kuptosh?, Atij trapit tënd, Idiote, Rrugë, debile, Si një qene rrugësh, Një këlyshe bushtre e gjetur në rrugë, je një qenie e pështirë, Trashaluqe, Rrugë i madh, Nje një qenie e poshtër, Je e përbindshme, Qelbësirë kriminele, Era qen, kafshë e lodhur pune, kafshë e lodhur.

## **Shqyrtime onomastike**

### **a) Emrat e banimit dhe tempujve**

Emrat e banimit dhe tempujve që kemi arritur të gjejmë në romanin *"Bolero në vilën e pleqve"* qytetit, Restorantin pranë stacionit të trenit, Sky Towrs, Buzë Unazës, Posta Qendrore, Turqi, Athinë, Poloni, Francë, Evropë, Shqipëri, Golem, Zonë rezidenciale në Golem, Vila e Plazhit, Shtëpia e fëmijërisë, Restoranti te Stacioni i Trenit, Apartamenti buzë Unazës, Kazino, Parku Rinia, Lana-lum, Shkolla e infermiereve në Tiranë, Spitali Nr.1, Kanada, Dhoma e Postbllokut, Udhëkryqin te Zogu i Zi, Lulishtja e pensionistëve, Stacioni i autobusit buzë rrugës, Pavijoni i kirurgjisë, Fakultetin e Inxhinierisë.

### **b) Emrat dhe mbiemrat si shenjë indentiteti**

Në romanin *"Bolero në vilën e pleqve"* kemi shumë emërtime si emra vetjake, emra të vjetër, emra fetarë, emra historik dhe emra të huaj. Afërdita, Fjora, Dirina, Edisoni, Eda, Adam, Ana, Iliri, Klajdi, Erion, Rajmonda, Agush Lena, Mond, Don Kishoti, Parashqevi, Leonard Voga, Irfan, Aleksandër Moisiu, Shopen, Seline Dion.

### **c) Emra kafshësh**

Në romanin *"Bolero në vilën e pleqve"* të Fatos Kongolit kemi arritur të gjejmë vetëmnjë shembull: Qen Pekinezë.

## **Shqyrtime leksikologjike**

### **a) Pasqyrimi i fjalëve të urta**

Fjalët e urta janë fraza të shkurtëra që shprehim me pak fjalë filozofinë popullore (urtinë popullore). Pikërisht për këtë, ato thirren nga populli edhe fjalë të urta. Fjalët e urta janë të përhapur në të gjithë botën dhe nuk ka dyshim se midis tyre hasen edhe ngjashmëri apo identitete. Nganjëherë është e lehtë të caktohet pak a shumë një moshë për një proverb të caktuar, por në më të shumtën është e vështirë aq më tepër që në rrymë të kohës, proverbat edhe evoluojnë e mund të marrin edhe trajta disi të ndryshme. Te romani *"Bolero në vilën e pleqve"* të Fatos Kongolit hasen këto fjalë të urta, si: Një shtëpi, po nuk u banua, rrënohet., Nuset që s'pillnin i çonin te bababi i teqesë, Mat shtatë herë, prit një herë, Pleqtë e kanë marrë të fshehtë me vete, Të gjithë ata që u kanë rënë dhëmbët i përmbahen parimit se të kafshosh është mëkat, Nuk qe e thënë, S'ke ymër as sa një zog pule. Më mirë një varr i mbyllur sesa i hapur. Qielli me tokën të puqeshin nuk do t'i nxirrja, Me një gur, do të vrisja dy zogj.

### **b) Pasqyrimi i njësive frazeologjike**

Frazeologjia si degë e leksikologjisë studion bashkimet leksiko-semantike të fjalëve dhe tërësinë (fondin) e njësive frazeologjike të një gjuhe të caktuar. Njësia frazeologjike si njësi gjuhësore me kuptim të mëvetësishëm, e përbërë nga dy ose më shumë fjalë shënjuese (emërtuese), me gjymtyrë e ndërtim të qëndrueshëm, e formuar historikisht e për një kohë të gjatë, që ka vlerën e një fjale të vetme, riprodhohet në ligjërim si njësi e gatshme dhe funksionon në gjuhë si njësi e pandashme e hasim edhe në veprat e Fatos Kongolit. Në romanin *"Bolero në vilën e pleqve"* të Fatos Kongolit kemi një numër të madh të njësive frazeologjike: Kishim rënë në ujdi, Ua mora dorën, Nuk e çante kokën, Zuri të na çajë kokën, Edhe nëse më hipën të leh, më tha një ditë, dua të leh vetëm, jo në tufë. Ta ka zënë rrota bishtin me ta, Me humor të prishur, Te shtëpia e të varurit s'është mirë ta kujtosh litarin! T'i çanin kokën me këshilla, Do ta kem pisk, Duhet t'i ketë ardhur në maje të hundës, E mora me mend, E le në dorën tënde, Më kanë ardhur në maje të hundës, Të hiqja dorë, I ke rënë pikës, E marrin me mend, U mor vesh botërisht, E shumëzuan me zero

bësnikërinë time të qenit, E kishte marrë veten, Gruan po e linin këmbët, Për të mos iu dorëzuar shtratit, Kush e çan kokën për mua, Jemi në fund loje, Shihja ëndrra me sy hapur, Të binte në sy, E dhanë pëlqimin, Të thante era, Ishte majë më majë me të vjehrrën, Ma hiqte trurin, Hoqa dorë, E poshtëruar për vdekje, Njerëzit lanin hesapet, Ka shtatë shpirtra ai, Në majë të hundës, Ma hiqte trurin, Ka vajtur për dhjamë qeni, I ra në sy, I kishte rënë në sy, Mu prenë gjunjët, Halerat hëngrën dhe, E kishte paguar me kokë, Lanë kokat ,Pa e çarë kokën,Në maje të gjuhës,T'ia ngrinte nervat, Ktheja me të njëjtën monedhë, I lashë numrat,Pa kokë e pa bisht, I dhashë zemër vetes, Ia solli në majë të hundës, Ia kishtë bërë naftën dashnorja,Sytë në tavan, Si një masë e ngrirë argjili,As e gjallë e as e vdekur, E morën sytë e mi,Mbeta pa frymë,U bë esëll,I bëra ballë, Për hesap të vet,S'më ra në dorë, Duhet të ketë pasur gisht dikush tjetër, Nuk ka dalë në dritë,Mos e çaj kokën,Mbetëm në këtë botë fillikat,U çakërdis truri,Më mbeti në fyt,E le në dorën tënde, Ke mendje të sëmurë,E çova ndër mend,S'je as e para as e fundit,Punë që s'bëhet,Punët s'janë mirë,M'u hiq nga sytë,Mos e çaj kokën,Në një rrugë pa krye,Mos e vrit mendjen,E mora me mend,Të hiqte dorë,Më bënin veshët,Mbaje vath në vesh, T'i qërojmë hesapet,M'i nguli sytë,Me shpejtësinë e breshkës, Kot vrisja mendjen,Ma preu shkurt,Sytë në tavan,Kishim rënë në ujdi,Të nxirrja mallin.

### **c) Pasqyrimi i dialektizmave**

Dialektizmat janë fjalë të cilat janë përdorur në të gjitha veprat e shkrimtarit edhe këtu kemi arritur të gjejmë fjalë dialektore si: po vete.

### **d)Pasqyrimi i arkaizmave**

Arkaizmat janë objekt i rëndësishëm studimi sepse janë studiuar vetëm në ligjërimin e përditshëm letrar e bisedimor. Në romanin *"Bolero në vilën e pleqve"* arritëm t'i gjejmë këto arkaizma : pusullë-Një copë pusullë.

### **e)Pasqyrimi i historizmave**

Historizmat janë përdorur në një periudhë të caktuar kohore dhe sot hasen kryesisht në letërsi ose në veprat shkencore që flasin për atë periudhë si psh:harbute.

### **f)Pasqyrim i huazimeve**

Huazimet nuk mungojnë asnjëherë në veprat letrare në përgjithësi, e veçanërisht në veprat e autorit, ku kemi arritur të mbledhim një numër të konsiderueshëm të fjalëve të huaja, që shumica janë turke: mesele,hesap, esëll, sekëlldi, smoking, kamxhik, hazdisura,sebeq,gusto,

dakord, blu, karrem, pazar, sixhade, tavan, gjynah, zor, çehrja, tabaka, kanotieren, triko, francezët e quajnë: "largeur d'esprit", korridor, pantollona xhins, t-shërt, vakt, gjerbte kafënë, çarçaf, këllëf, jastëk, hatri, haraçi, dollap, bollëk, bezdiste, sahat, angari, post-mortum, shyqyr, marifet, ymër, sodisni, amanet, sebepe.

Në romanin "*Bolero në vilën e pleqve*" të Fatos Kongolit hasim shembuj nga instrumentet muzikore ai që përmendet është: Pianoja.

## VEPRA II

### ROMANI "I HUMBURI"

Historia e romanit "*I humburi*" zhvillohet disa kapituj në të shkuarën dhe për disa kapituj të tjerë në të tashmen. Ky kryqëzim kohësh bëhet për të dhënë sa më fuqishëm dramën e personazheve, pamjet e jetës dhe bëmave, odisejadën jetësore të tyre. Ky roman që kur e lexon dhe studion të bën për vete hapet me përshkrimin e ikjes së mijëra shqiptarëve, në mars të vitit 1991, nga Shqipëria. Ikje jo aq nga rreziku i persekutimit policor, ngase regjimi totalitar ishte në shembje e sipër, sa nga vendi ku ishin shtresëzuar pasojat e sundimit të këtij regjimi. Histori e personazhe të shumtë në roman: Dorian Kamberi, Xhoda, Vilma, Fagu, Hulusiu, Arsen Mjalti, djali i ministrit A.P., Sonja, Ladi, Linda, Sherifi, Xhohu, Lulu-ja. Personazh kryesor është Thesar Lumi. Historia e romanit "*I humburi*" zhvillohet në disa kapituj në të kaluarën me historitë që kishin ndodhur dhe në disa kapituj të tjerë në të tashmen në historitë që ndodhin dhe janë interesante. Estetikën e artit letrar Kongoli e shpërfaq në dramën e personazheve, pamjet e jetës së tyre dhe bëmave të tyre, odisejadën jetësore të tyre që kalojnë ditë për ditë. Sipas personazhit kryesor Thesar Lumi-Sari, të qenit i tashëm, s'të privon nga të qenit i djeshëm, sikur që as e nesërmja s'mund të privojë kurrsesi nga e djeshmja dhe e sotmja, pra kjo është shumë e thellë dhe që të bën të mendosh shumë gjëra në jetë. Romani "*I humburi*" është një pasqyrë e qartë dhe tronditëse e shoqërisë autoritare, tiranike, e deri edhe jo-njerëzore në Shqipërinë komuniste tregon për historitë e njerëzve, jetët e tyre. Më shumë se një tregim për një shoqëri të caktuar, ky rrëfim ineteresantë tregon se si funksionon një shoqëri e cila ekzistencën e saj e bazon në frikë dhe bindje, frikë sepse të gjithë i kishin frikë drejtorit, drejtori i kishte frikë inspektorit dhe të gjithë bindeshin, një analizë e tillë vlen për të gjitha kohërat e për të gjitha shoqëritë pra edhe për kohën që jetojmë ne tani. Pushteti dhe mekanizmat e tij janë të pranishëm në një formë apo

tjetrën kudo që shkojnë njerëzit, herë më të drejtpërdrejtë, e herë i fshehur nëpërmjet mekanizmave mbrojtës. Romani *"I humburi"* tregon rrezikun që i kanoset njeriut nga sisteme të tilla të bazuara në bindje dhe autoritet sepse po kundërshtove nuk je në jetë më. Nëpërmjet personazheve të veprës autori përshkruan të gjithë mekanizmat e një shoqërie të tillë. Të gjithë personazhet së bashku ndërtojnë mozaikun e tmerrshëm që të trishton tërë qenien. Secili është në vendin e tij apo të saj. Autori me kujdes i zbërthen personazhet dhe na mundëson të njohim në thelb ekzistencën e shoqërive autoritare dhe ia del. Ngjarjet zhvillohen në Shqipërinë e periudhës komuniste dhe paraqesin kujtimet e jetës së Thesar Lumit. Nëpërmjet jetës së tij ai rrugëton nëpër skutat më të errëta të një shoqërie autoritare sikurse ishte ajo në Shqipëri. Në aspektin etnolinguistik është e mbushur me elemente të tilla të cilat i keni në këtë punim të doktoratës.

## **1. SHQYRTIME ETNOKULTURORE**

### **a) Përdorimi i nofkave**

Nofkat e mbledhura në romanin *"I humburi"* të Fatos Kongolijanë këto: Xheloz i marrë, Tigri vdekjembartës, Xhoda i Marrë, Xhoda i Tmerrshëm, Gardiani i fëmijërisë së çapaçulëve të qytezës, Gardiani i fëmijërisë së disa brezave, Gardiani Xhodë, Çapaçuli, Oficeri fytyrëkuq, Hajduti i xhepave, Ungji i famshëm biografiprishës, Qejfli grash, Tipat më kokëshkretë të shkollës, Bija e pisit, Klani i Fagut, I shumëzuar me zero, Ministër i fuqishëm, Tipi i vjetër sovjetik, Hermesi breglumas, Marroku.

### **b) Përdorimi i eufemizmave**

Si strategji të rëndësishme, ta quajmë etnolinguistike, autori Fatos Kongoli në romanin e tij përdor edhe eufemizmat, sepse gjuha pa eufemizma paraqet një mjet të dobët komunikimi. Eufemizmat e mbledhura në romanin *"I humburi"* të Fatos Kongolit janë këto: Pushteti i makthit, Djemtë e gaxhojve, Mullinjtë e fabrikës, Zorraxhinjtë e klubit, Oficer polide. kokëmadh, Engjëlli bamirës, Brezi i Mjegullës, Baraka gabelësh, Bamirësit tonë të përjetshëm, Gabelët e bregut të lumit, Lukuni bastardësh, Gruaja qiellore, Bastardë të fisëm.

### **c) Përdorimi i urimeve dhe fjalëve përkëdhelëse**

Gjatë analizës së romanit *"I humburi"* të Fatos Kongolit arrijmë të gjejmë edhe emra përkëdhelës, që në fjalor na jep këto shpjegime: 1. që përkëdhel, që shpreh dashuri a

ëmbëlsi, i këndshëm, ledhatues: shikim përkëdhelës, fjalë përkëdhelëse. 2. *gjuh.* që ka ngjyrim zbutës a mirëdashës, që me trajtën e vet shpreh përkëdhelje a zbunim: emër përkëdhelës, prapashtesë përkëdhelëse.

Në veprën "*I humburi*" arritëm t'i gjejmë këto urime: Bravo, deri këtu arsyetimi nuk çalon, Të lumtë gjithmonë ke qenë i shkathët, Qofsh ti!, Të uroja që bashkë me mua të ngrinte edhe koha. Në veprën "*I humburi*" arritëm t'i gjejmë këto fjalë përkëdhelëse: trashaluke babaxhane.

### **ç) Përdorimi i mallkimeve popullore**

Perkrah kulturës dhe traditës, shkrimtari Fatos Kongoli, në veprat e tij ka përdorur edhe mallkimet. Këto janë forma të të shprehurit të inatit, zemërimit të cilat gjejnë përdorim në të folurën popullore të përditshme. Gjatë analizës së romanit "*I humburi*" të Fatos Kongoliarritëm t'i gjejmë këto mallkime popullore: Zot ç'jetë qeni. U orvata të gjeja në isha unë i paracaktuar nga providenca, si mallkim për Xhodën në ditët e çmendurisë. Mallkova veten, Mallkonte, pa guxuar t'i binte drejt. Hëngshin kokat. Na hëngërt mortja. Të bëj të hash dhe. Mos të pafsha kurrë. I ngrëntë mortja. Si mallkim i njëri-tjetrit, derisa të mos jemi më as unë, I humburi, as ti, i çmenduri. As sytë e Bardhë.

### **d) Përdorimi i ngushëllimeve**

Autori Fatos Kongoli, në veprat e tij ka përdorur edhe ngushëllime me të cilat përmes fjalëve ka shprehur dhimbjen e vdekjes. Gjatë analizës së romanit "*I humburi*" të Fatos Kongolit arritëm t'i gjejmë këto ngushëllime që shprehen më shumë: Një fetar i mirë ngushëllohet e gjen qetësinë e shpirtit në shprehjen "kështu qe shkruar".

### **e) Ofendimet (sharrjet)**

Përdorimi i gjuhës fyese, shantazhet, kërcënimet, përçmimet etj. kanë qenë të pranishme edhe në jetën e përditshme të popullit tonë me shekuj. Shkrimtarët shpesh në veprat e tyre kanë përdorur edhe ofendime për ta reflektuar më mirë gjuhën e popullit por edhe për t'i dokumentuar ata. Në veprat e tij, Fatos Kongoli ka përfshirë shumë ofendime. Gjatë analizës së romanit "*I humburi*" të Fatos Kongolit arritëm t'i gjejmë këto ofendime (sharrje): Hajdut, gomarllëqet, maskara, kopuk, delenxhi, servil, qyqari, budallenj, zagarë, maskarenj, bastardët, rrugaç, qurraveceje, haraç, mjeran i shkretë, kodosh, qenve zgjebanjosë, Si një

majmun i Kopshtit Zoologjik, teveqel, gomar, Ti je i çmendur, I pabesë, Familjet e mëdha janë më të poshtra, Familjet e mëdha janë më të ndyrat, Si një qen i zbuar, Si një qen që e zënë me gurë. Si një bastard rrugësh, Torollake, Je një bastard më i zgjebosur se unë, teveqel, debil, ndyrësirë, Do t'i bëj turinjtë përshesh, Je një frikacak i ndyrë, Shushkë, Maskarenjtë, Hajdutë ordinerë, Kodoshbashe, Qelbësirë, Hajvan, Qelbanik, Muti i mutit, Halabaku, Vagabondi, rospi, Bastardë rrugësh, të uritur, të mardhur, të përzënë me shqelma, bastard i rrugës, trupeshk.

## **Shqyrtime onomastike**

Autori Fatos Kongoli, kësaj dege gjuhësore i jep një rëndësi të veçantë duke na ofruar shumë shembuj. Kështu në romanin "*I humburi*" janë përfshirë emra të viseve të cilat quhen ndryshe toponime, emra të njerëzve të cilat quhen ndryshe antroponime dhe emra familjarë që ndryshe quhen patronime.

### **a) Emrat e banimit dhe tempujve**

Emrat e banimit dhe tempujve që kemi arritur të gjemë në romanin "*I humburi*" janë këto: Itali, Evropë, Tiranë, Durrës, Fier, Vlora, Teatri i Kukullave, Fshati K, Dyqane ushqimoresh, Qyteza e Bregut të Lumit, Qebaptorja "Bregu i lumit", Hotel "Dajti", Parku përballë hotel "Dajtit", Udhë e varrezave, Qendra e qytezës, Lagjia e bregut të lumit, Vila e Durrësit, Shkolla Pedagogjike, Lulishte me ligustra, Shtëpia e fëmijës, Shteti i Molouskëve, Bulevardi i Madh, Agjenci ajrore, Restorant "Donika".

### **b) Emrat dhe mbiemrat si shenjë indentiteti**

Në romanin "*I humburi*" kemi shumë emërtime si emra vetjake, emra të vjetër, emra fetarë, emra historik. Emrat dhe mbiemrat që hasëm janë këto: Dorian Kamberi, inxhinier mekanik, Dori, Arsen Mjalti- ish-brigadier në fabrikën e çimentos, Skënderbeu, Thesar Lumi, Vilma, Xhoda, Fagu, Sherifi, Hulusiu, Riku, Vladimir-Ladi, Shën Vladimiri, Xhohu, Sonja, Ermelinda, Martin Ideni, Xheni, Oliveri, Sonja, Sparti, Linda, Thesar-Sari-Thesi, Luluja, Tanci, Niagara, Brizhit Bardoja, Gazi, Llambro, Baldosa.

### **c) Emra kafshësh**

Në romanin "*I humburi*" të Fatos Kongolit kemi arritur të gjejmë këto emra kafshësh: Qen Kone me emrin Maksi, Drita e syve të Vilmës, Valerenë-mushkë,



## Shqyrtime leksikologjike

### a) Pasqyrimi i fjalëve të urta

Fjalët e urta janë fraza të shkurtëra që shprehim me pak fjalë filozofinë popullore (urtinë popullore). Pikërisht për këtë, ato thirren nga populli edhe fjalë të urta. Fjalët e urta janë të përhapur në të gjithë botën dhe nuk ka dyshim se midis tyre hasen edhe ngjashmëri apo identitete. Nganjëherë është e lehtë të caktohet pak a shumë një moshë për një proverb të caktuar, por në më të shumtën është e vështirë aq më tepër që në rrymë të kohës, proverbat edhe evoluojnë e mund të marrin edhe trajta disi të ndryshme. Te romani *"I humburi"* të Fatos Kongolit hasen shumë fjalë të urta, si: Të gjithë ikën, ju lanë pendët, Kur njeriu mësohet me dru, nuk i hyn më në sy asgjë, Ne s'mund të bëheshim erë, Pjella e bashkimit të gjarprit me iriqin është një tel me gjemba, Një hiç mund ta shtyp me këmbë kushdo, Bota kish ndërruar ngjyrë, Në sytë e mi shihte sytë e tij, Fati na është qepur me gurë, Nuk isha zog e nuk kisha krahë të fluturoja, Hedh gurin e fsheh dorën, Kur fati më zgjati dorën, unë flaka thikën, Ai që mban thikë, nga thika e gjen. Kobet rrinin varur në ajër, Qentë le të lehin, karvani le të shkojë përpara, Gjurmë që as varri nuk t'i shlyen, Qaje hallin si burri-burrit, e mali me malin s'piqen, por njerëzit piqen, Murit nuk i bihet me kokë, Më të vjetrit pohojnë se që nga ajo kohë nisi vdekja e ngadaltë e qytezës, Një shpirt ngjadhënjën drejtësisë, më saktë ndjenja e drejtësisë. Grushtit e thikës nuk i trembet.

### b) Pasqyrimi i njësive frazeologjike

Frazeologjia si degë e leksikologjisë studion bashkimet leksiko-semantike të fjalëve dhe tërësinë (fondin) e njësive frazeologjike të një gjuhe të caktuar. *Njësia frazeologjike si njësi gjuhësore me kuptim të mëvetësishëm, e përbërë nga dy ose më shumë fjalë shënjuese (emërtuese), me gjymtyrë e ndërtim të qëndrueshëm, e formuar historikisht e për një kohë të gjatë, që ka vlerën e një fjale të vetme, riprodhohet në ligjërim si njësi e gatshme dhe funksionon në gjuhë si njësi e pandashme* e hasim edhe në veprat e Fatos Kongolit. Në romanin *"I humburi"* të Fatos Kongolit kemi një numër të madh të njësive frazeologjike: I ka larë hesapet, Një hut ë shëndoshë, Shpirti m'u qetësua, Duke kaluar nga dora në dorë,

S'kishte vënë dorë mbi mua, Njëpër mend, Shkuli veshët, E marrin njëpër këmbë, Kalltë frikën, I bën qejfin vetes, Hije mbi tokë, Kohët bëhën lëmsh, Si një qen rojë, Mjerë kush guxontë t'i prekte një qime floku, As e vrisja mendjen, Hoqa dorë, Të vrisja mendjen, Ia hidhnin, Gënjenin në sytë tanë, Më shkonin mornica, Si puna e qenve, Vdiste nga frika, Vdiste nga tmerri, Pa rënë në sy, Më kishte bërë esëll, Në gojën e zezë, Nuk më ka lënë gjurmë, Xhepi nuk m'i mbante çmimet, Për të hedhur një sy, I fyer në sedër, I pëlqente hunda ime, Mund të haje ndonjë lëmsh bore, Si një copë lecke, Më ngriti nervat, Ngjyrat ndryshuan, E ktheva me një frymë, Po më hante të gjallë, Për ta merrë veten, Hap sytë, M'u vërtit në kokë, Punën e ke pisk, Zemra më kërceu përjetë, S'vura gjum në sy, Midis dy zjarresh, E mbajta jashtë valles, S'do më linte në baltë, Të mos i shkelnin këmbët, E mangët nga trutë, S'vumë gjumë në sy, U bëra esëll, Ata shkojnë si macja me miun, Nuk ra në sy, Nuk më ra në sy, Nga koka te këmbët, Ishin qepur për mua, Mos çaja kokën për kurrkënd, Mos e çaj kokën, E marr me mend, Më rrinte gozhdë në tru, Kishim rënë në sy, I ra shkurt, Më erdhi në maje të gjuhës, Ktheu shpinën, E mblodha të qepja gojën, U ishim bërë halë, Nuk e çaja kokën, Më duhet ta qepja gojën, Brengë që më kafshon, Me lepurin në bark, Vdiste nga frika, S'e çante kokën, Me zemër të ngrirë, Për t'i dhënë zemër, Më kishte hyrë frika në palcë, Më ra në sy, Këmbët e dinin punën e tyre, M'u morën mendtë, I hidhnin ndonjë fjalë, M'i nguli sytë, Më kishte ardhur në majë të hundës, Me frikën në sy, Si zorret e barkut të prishur, Thyen kokën, Ia kishin hedhur trutë, Mori zemër, U kthye pas një shekulli, Ktheu shpinën, S'na hidhte as sytë, Kur të shohësh majën e veshit tënd, I ka thirrur logjikës, Si ata qengjat e butë, Si peshku në zall, Dhëmbin sa të elefantit, E mata me sy, I kalova nën hundë, Kur të shohësh majën e veshit pa pasqyrë, Donte të më jepte zemër, E mora me mend, Nervat më ranë, S'më hynin në punë, Ua hodhe bukur, Njerëzit të hanë me sy, Të ta bëjë gropën, Ëndrra me sy hapur, të ha edhe kokën, Të vras ty dhe vet dal i larë, Nga koka te këmbët, Qafën e trashë, Ujku shqeu një qengj, Në këtë mes mali për gurët e sokakut, Një lëmsh m'u mblodh në fyt, Këmbët më çuan te varrezat, U bëra i tëri vesh, Mbeta i harruar, Sedra s'më linte të kërkoja ndihmë, Djall me brirë. Mbeti si një trung i goditur nga rrufeja.

### **c) Pasqyrimi i dialektizmave**

Dialektizmat janë fjalë të cilat janë përdorur në të gjitha veprat e shkrimtarit edhe këtu kemi arritur të gjejmë fjalë dialektore si: Tim eti, Vajta, s'vajta, Yt ungj, qysh, je një çik, je kalama, Vajtur puna.

#### **d)Pasqyrimi i arkaizmave**

Arkaizmat janë objekt i rëndësishëm studimi sepse janë studiuar vetëm në ligjërimin e përditshëm letrar e bisedimor. Në romanin "*I humburi*" arritëm t'i gjejmë këto arkaizma : Pusullë.

#### **e)Pasqyrimi i historizmave**

Historizmat janë përdorur në një periudhë të caktuar kohore dhe sot hasen kryesisht në letërsi ose në veprat shkencore që flasin për atë periudhë si psh : Thembra e Akilit, Ngrehina prehistorike.

#### **f)Pasqyrim i huazimeve**

Huazimet nuk mungojnë asnjëherë në veprat letrare në përgjithësi, e veçanërisht në veprat e autorit, ku kemi arritur të mbledhim një numër të konsiderueshëm të fjalëve të huaja, që shumica janë turke dhe sllave: tavan, merak, stol, sosën, sehir, xhelat, hesap, kollaj, oborr, esëll, çarçaf, qorrsokak, sahat, bezdi, batërdia, nursëze, dalldi, jastëk, robëdëshambër, apartament, pishmanllëk, tavëll, bravë, dollap, blu, hasëm, telashe, parmak, çehrja, boshllëk, xhezve, pazar, mesele, pazarllëku, komshi, zagushia, hafije, marifet, surrat, ymër, zanat, begenis.

Në romanin "*I humburi*" të Fatos Kongolit hasim shembuj nga instrumentet muzikore ai që përmendet

është:

Pianoja.

Titujt e këngëve dhe këngët që i hasim janë: Të bindur së ishim fëmijët më të lumtur në botë,

Love

story.

Në romanin "*I humburi*" kemi vetëm instrumentin e pianos që përmendet të roman. Po ashtu këngë kemi edhe titull në gjuhën angleze si: Love story.

### **VEPRA III**

#### **ROMANI "LËKURA E QENIT"**

I cilësuar si një libër mjaft i lexuar dhe i interesant, ku shkrimtari Fatos Kongoli arrin nivelin më të lartë të prozës, "*Lëkura e qenit*" është vlerësuar shumë dhe është përkthyer në shumë gjuhë të huaja. Personazhet e këtij libri të kujtojnë dëshira dhe vese që çdokush i mban fshehur nën vete, që çdokush i prek e i ledhaton, i fundos në thellësi të vetëdijes, pa i lënë kurrë të dalin në pah pra krejtësisht të zhveshura nën e të tjerëve. Në këtë roman, ku fytyra e shëmtuar e botës vetëm rrallë, të lejon të vështrimin shohësh anën tjetër të me-daljes,

